Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo

Komuna e Kaçanikut
Opština Kacanik
Municipal Kacanik
-Kuvendi i Komunës-

01Nr.60/01 – 4535/22
Kaçanik, 28.02.2022

Kuvendi i Komunës Kaçanik, në mbledhjen e vet të mbajtur më datë: 28 shkurt 2022, pos tjerash;

**NJOFTOHET**

1. Me Raportin Vjetor të punës së ekzekutivit të komunës, për periudhën Janar-Dhjetor 2021.

2. Në njoftimin si në pikën 1 të kësaj shkrese janë paraqitur sfidat dhe të arriturat e ekzekutivit të Komunës për periudhën 01 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021.

3. Pjesë përbërëse e kësaj shkrese, është; "Raporti Vjetor i Ekzekutivit të Komunës për vitin 2021/Lënda 01Nr.60/01-4535/21.

**Më këtë shkresë njoftohen:** Kryetari i Komunës, dhe përmes zyrës së Kryetarit njohtohen edhe Drejtoritë komunale dhe Arkivi.

Kryesuesi i Kuvendit
Kemal Murseli

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E KAÇANIKUT
OPŠTINA KAČANIK

| I | Data 16.02.22 | Vendi KAÇANIK |
|---|---|---|
| Nj. org. | Numri | Shtojcë |
| 01 | 060/01-425 | / |

# Raporti vjetor 2021

**Ekzekutivi i Komunës**

Tel 038 200 46400 Rr. Qamil Ilazi 71000, Kaçanik www.kk.rks-gov.net/kacanik

FJALA E KRYETARIT

Të nderuar qytetar,

Ndjehem mjaft i lumtur që nëpërmjet këtij dokumenti, të raportoj për punën e ekzekutivit për vitin 2021. Viti që shkoi, ngërtheu në vete shumë sfida e ndryshime në mënyrën se si ne drejtuam institucionin duke marr parasysh ballafaqimin me pandeminë. 2021 na përcolli me shumë ngjarje e projekte të cilat i realizuam së bashku. Transparenca dhe llogaridhënia për ne tashmë janë shndërruar në mekanizëm jetik për qeverisjen tonë. Këto mekanizma janë instaluar dhe përkrahen fuqishëm në çdo sferë duke përfshirë shërbimet administrative dhe menaxhimin e projekteve kapitale. Rezultati i angazhimit tonë ka qenë ndërtimi i një niveli më të madh besimi ndërmjet komunës dhe qytetarëve, në mënyrë që komuna të përmbushë pritjet dhe kërkesat e tyre.

Sot, derisa raportojmë për 2021, duke marrë parasysh pandeminë që ka përfshirë globin urojmë e shpresojmë se 2022 do të jetë ndryshe. Kur themi "ndryshe", nënkuptojmë fillimisht me zhdukje të pandemisë dhe së dyti me fillim të implementimit të platformës qeverisëse "Bashkë për Kaçanikun".

Në vazhdim të këtij raporti, do të njoftoheni me të gjitha aktivitetet e Komunës së Kaçanikut të cilat janë realizuar në harmoni të plotë me autorizimeve ligjore që kam si Kryetar i Komunës siç janë realizimi i shumë projekteve infrastrukturore, si rrugë me trotuare e ndriçim, ujësjellës e kanalizime, investime në sektorin e bujqësisë, në infrastrukturën arsimore e sportive.

Mirëqenia e kategorive sociale ishte në vëmendjen tonë, ku edhe këtë vit kemi vazhduar me ndihma momentale. Vëmendje të veçantë i kemi kushtuar edhe personave me nevoja të veçanta, ku në vazhdimësi kemi përkrahur aktivitetin e organizatave që punojnë për mirëqenien e tyre, duke i mbështetur edhe me mjete financiare.

Kryetari i Komunës së Kaçanikut

Z. Besim Ilazi

## Drejtoria e Administratës së Përgjithshme

Një nga synimet kryesore të administratës komunale është arritja e efikasitetit në të gjitha nivelet. Institucionet publike janë përgjegjëse për të siguruar të mirat dhe shërbimet e nevojshme publike për qytetarët pa asnjë diskriminim. Prandaj, objektivat shumëdimensionale të administratës komunale kërkojnë që performanca jo vetëm të jetë e kufizuar në ofrimin e shërbimeve, por gjithashtu të përfshijë elementin thelbësor të sigurimit të vlerave llogaridhënëse për qytetarët.

Në kohën bashkëkohore, pikëpamjet e duhura se si duhet të funksionoj administrata komunale orientohen kryesisht me përparimin në teknologji që pritet të ketë ndikim të jashtëzakonshëm në evolucionin e ofrimit të shërbimeve si një fushë dinamike e së ardhmes.

Drejtoria e Administratës është tradicionalisht e angazhuar në arritjen e efikasitetit në punën e dikastereve të saj, me theks të veçantë në ofrimin e shdërbimeve. Prandaj, efikasiteti gjen një vend të përhershëm në planprogramin e qeverisjes lokale. Efikasiteti dhe efiqienca merr një vemendje të rëndësishme kur përpiqemi ta aplikojmë atë në një sistem që bazohet në shumë vlera, profesionalizëm e transparencë të zyrtarëve të angazhuar publik. Dimensioni i transparencës i jep një perspektivë unike efikasitetit në ofrimin e shërbimeve.

Drejtoria e Administratës përkushtimin e saj e bazon në tri shtylla: efikasitet, performancë, transparencë. Këto mekanizma janë instaluar dhe vazhdojnë të përkrahen nëpërmjet investimeve kapitale në vazhdimësi. Investime këto kryesisht në teknologji, infrastrukturë të objektit dhe investime tjera të rëndësishme. Mbi këto parime, DAP ka ushtruar funksionin e saj statutor dhe në këtë raport shfaqet puna një vjeqare e kësaj drejtorie bashkë me sektorët e saj sipas organogramit.

KAÇANIKU

RAPORTI VJETOR 2021

## Qendra Komunale për Shërbime me Qytetar

Njëra ndër sektorët më vital për funksionim të duhur të institucionit lokal është Qendra për Shërbime me Qytetar.

Gjatë vitit 2021, janë pranuar dhe proceduar 32681 lëndë, vetëm 426 prej tyre kanë ngelur në proces. Krahasuar me vitin paraprak vërehet rënie e lëndëve për 8441 më pak.

| *Përshkrimi* | *Pranuar* | *Në Proces* | *Miratuar* | *Refuzuar* | *Përfunduar* | *Totali* |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Drejtoria e Administratës së Përgjithshme** | 47 | 6 | 2409 | 8 | 18724 | 21204 |
| **Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës** | 40 | 95 | 1032 | 76 | 0 | 1284 |
| **Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë** | 10 | 9 | 842 | 118 | 0 | 980 |
| **Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit** | 10 | 105 | 6853 | 2 | 0 | 6977 |
| **Drejtoria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale** | 5 | 65 | 34 | 3 | 0 | 110 |
| **Drejtoria e Emergjencës dhe Shërbimeve Publike** | 28 | 15 | 468 | 78 | 0 | 592 |
| **Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit** | 76 | 1075 | 5141 | 5 | 0 | 6331 |
| **Shërbimi i Kryetarit** | 74 | 159 | 1210 | 447 | 0 | 1900 |
| | **290** | **1525** | **17989** | **737** | **18724** | **39378** |

*Tab. 1. Raporti sipas departamenteve dhe statusit të zgjidhjes prej 01/01/2021 – 31/12/2021.*

## Zyra Komunale e Gjendjes Civile

Zyra Komunale e Gjendjes Civile për vitin 2021 ka realizuar detyrat dhe përgjegjësitë në saje të autorizimeve ligjore si në vijim:

| Përshkrimi | Copë |
|---|---|
| **Ekstrakte te Lindjes** | 16296 |
| **Certifikata te Lindjes** | 4825 |
| **Certifikata e Martesës** | 3323 |
| **Certifikata e Vdekjes** | 1200 |
| **Certifikata e Gjendjes Martesore** | 863 |
| **Deklarata Familjare** | 2361 |
| **Certifikata e Vendbanimit** | 1120 |
| **Certifikata e Shtetësisë** | 193 |
| **Vërtetime te Arkivit** | 710 |
| **Dëshmi Vdekje** | 52 |
| | **Totali: 30943** |

*Tab. 2. Numri i certifikatave të lëshuara nga data 01/01/2021-31/12/2021.*

| Përshkrimi | Copë |
|---|---|
| **Regjistrime të Lindjes të Rregullta** | 2 |
| **Regjistrime të Lindjes të Veçanta** | 243 |
| **Shpallje të martesave** | 247 |
| **Kurorëzime** | 247 |
| **Kurorëzime speciale** | 88 |
| **Regjistrime të vdekjes të rregullta** | 198 |
| **Regjistrime të vdekjes speciale** | 36 |
| **Lëndë të kompletuara për fitim të shtetësisë** | 21 |
| **Lëndë të kompletuara për humbje të shtetësisë** | 36 |
| **Vendime të ndryshme** | 101 |

*Tab. 3. Numri i akteve të lëshuara nga data 01/01/2021-31/12/2021.*

Në kuadër të punës të ZKGJC janë përgatitur statistikat mujore dhe janë dërguar me kohë në Agjencionin e Statistikave të Kosovës si dhe të gjitha gabimet për përmirësim janë dërguar me kohë në ARC.

Gjatë po këtij viti, është instaluar dhe funksionalizuar e-kiosku në hyrje të objektit të Komunës.

Janë mbajtur takime në lidhje me problemet dhe vështirësitë e ndryshme që përcjellin punën e përditshme të kësaj zyre. Njashtu janë bërë vizita në terren përveç kohës së masave strikte me ç'rast zyrat janë mbyllur por shërbimet nuk janë ndalur asnjëherë.

## Arkivi

Gjatë vitit 2021, Sektori i Arkivit ka punuar dhe është angazhuar me punimin, rregullimin, klasifikimin, sistemimin e lëndëve arkivore sipas njësisë organizative. Gjithashtu është bërë valorizimi regjistrimi (përzgjedhja) e lëndëve arkivore me afate të ruajtjes prej vitit 1955-1970, 21 kuti.

**Shërbimi pronësoro-juridik lëndë të Komisionit për Konfiskimin e pasurisë, nacionalizim, shpronësim dhe uzurpimet** 1946-1966, sasia 10 kuti.

-BVI-a për Arsim 1962-1992 gjithsej 17 kuti .

-Drejtoria për Administratë të Përgjithshme 1981-1996-sasia 8 kuti.

**Gjithsej:56 kuti.**

-Asgjësim e materialeve të cilave ju ka kaluar afati dhe si të tilla nuk e kanë cilësinë e lëndës arkivore si dublikate, kërkesa të ndryshme, dënime mandatore etj. për të cilat është hartuar procesverbali për asgjësim.

- Hartimin e Librareve Arkivore të lëndëve arkivore të Kuvendit Komunal me të gjitha drejtoritë dhe sektorët e tyre prej periudhës 1946-mars 1999.

-Regjistrimin dhe vendosjen në kutia të dosjeve pasive të punëtorëve të KKK. sasia 49 kutia dhe të Ekonomisë pyjore 11 kutia. **Gjithsej: 60 kuti.**

-Shqyrtimi i kërkesave të ndryshme dhe llogaritja e stazhit të punës për plotësimin e formularit **M4**, vërtetime të ndryshme.

**2.PUNË NË DEPO**

**-**Bartja e dokumenteve nga depo për të i punuar në zyrë dhe anasjelltas duke i vendosur në vendet përkatëse.

-Pranimi i materialeve të Kuvendit të Komunës - Legjislatura e –V-të - 2013-2017 sasia 26 kuti.

**-Intervistë për RTK**. lidhur me ruajtjen dhe mbrojtjen e lëndës arkivore me vlera shoqëroro-historike ndër vite të Komunës së Kaçanikut.

-Sipas kërkesave të zyrtarëve komunal dhe palëve , kemi bërë hulumtimin për gjetjen e lëndëve të kërkuara dhe kthimin e tyre në vendin përkatës.

**3. KËRKESA INTERNE-** nga zyrtarët e drejtorive të komunës dhe përfaqësuesit ligjor janë parashtruar 153 kërkesa gojore për gjetjen e lëndëve dhe projekteve arkivore, të njëjtat janë kthyer duke i vendosur në vendin përkatës.

**4. KËRKESA TË PARASHTRUARA NGA PALËT** – 97 kërkesa prej tyre 18 për llogaritje dhe plotësimin e formularit të stazhit të punës M4.

-Palëve të interesuara ju kemi dhënë udhëzime profesionale komfor ligjit për Arkivat dhe Ligjit për Qasje në Dokumente Zyrtare të Republikës së Kosovës.

KAÇANIKU

## Njësia komunale për të drejtat e njeriut

Parim i NJKDNJ-së është mbrojtja dhe promovimi i të drejtave të njeriut në përgjithësi me standardet ndërkombëtare në nivel komunal si dhe takimet e rregullta me avokatin e popullit si dhe OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare të cilat kontribuojnë në çështjen e lirive dhe të drejtave të njeriut.

Kjo njësi i ka përmbushur pritjet sipas planit të punës për vitin 2021.

## Mirëmbajtja e objektit dhe autoparku

Gjatë vitit 2021, DAP nëpërmjet sektorit teknik, është përkujdesur për higjienën, pastërtinë, mirëmbajtjen e nxemjes, mirëmbajtjen e aseteve tjera etj. Ky sektor ka kontribuuar në vendosjen e dezinfektueseve në zona të caktuara në komunë etj.

Veturat zyrtare kanë qenë në dispozicion për të gjithë zyrtarët publik përgjatë vitit. Meqenëse ishte vit zgjedhor, u janë dhënë veturat në shfrytëzim KKZ-së në të mirë të mbarvajtjes së zgjedhjeve lokale.

KAÇANIKU

**Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit**

**Sektori i Urbanizmit**

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Këkesa për kushte ndërtimi | 19 |
| 1.1 | Kushte ndërtimore të miratuara | 18 |
| 1.2 | Kushte ndërtimore të refuzuara | 1 |
| 2. | Kërkesa për leje ndërtimi | 19 |

2.1 Të aprovuara 18

Nga Lejet e Ndërtimit, të cilat janë lëshuar 1 i takojnë kategorisë së dytë.

3. Kërkesa për legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje

3.1. Gjatë vitit 2021 është punuar për regjistrimin e lendëve të legalizimit të objekteve të ndërtuara pa leje. Është punuar regjistri i lëndëve të pranuara nga vitit 2019 deri në vitin 2021, dhe atë gjithsej 500

3.2. Kërkesa të pranuar në vitin 2021 321

3.3. Kërkesa të aprovuara 175

3.4. Kërkesa të dorëzuara në Kadastër për procedurë të mëtejshme 175

3.5. Kërkesa në pritje 32

4. Kërkesa për leje mjedisore 5

4.1. Kërkesa të aprovuara 5

5. Shfrytëzimi i tokës apo lokaleve të Komunës

DUKMM, bën menagjimin e shfrytëzimit të tokës dhe lokaleve të komunës. Në evidencën tonë janë gjithsej 86 shfrytëzues. Per 51 prej tyre drejtoria ka lëshuar kontrate për shfrytëzimin e tokës apo lokalit. Të njëjtit i kryejnë obligimet e tyre direkt në DUKMM. Për 35 shfrytëzues, për shkak të mosshlyerjes së obligimeve lëndët i janë dorëzuar përmbaruesit privat dhe inkasimi i borxhev bëhet përmes tij.

6. DUKMM ka pranuar 13 kërkesa për ndërrimin e destinimit prej tokës bujqësore/pyjore në tokë ndërtimore. Te gjitha janë shqyrtuar dhe janë dorëzuar në Drejtorinë e Bujqësisë për proceim të mëtëjshëm.

7. Drejtoria e Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit ka marre 154 kërkesa për lëshimin e vërtetimit se komuna nuk është e interesuar për blerjen e tokës. Për të gjitha kërkesat është lëshuar vërtetimi.

Gjatë vitit 2021, Sektori i Urbanizmit në DUKMM ka realizuar të hyra në vlerë prej:

- Lejet e ndërtimit 112681.47€
- Lejet e legalizimit 29196.44€
- Lejet mjedisore 12746.25€
- Të hyrat nga shfrytëzimi i tokës ndërtimore 12325.64€
- Vërtetime 770.00€

Gjithsej: 167719.80€

8. Gjatë vitit 2021, në kuadër të projektit të drejtorisë së Urbanizmit, Kadastrit dhe Mbrojtjes së Mjedisit "**Rregullimi dhe asfaltim i rrugëve lokale**" janë menaxhuar dhe implementuar edhe **23** rrugica tjera me shtresë asfalti dhe kubëza me gjatësi 6444m dhe **4** rrugica me shtresë zhavori në gjatësi=**1230.50m**

| Nr. | Emërtimi | Gjatësia/m |
|---|---|---|
| 1 | Rehabilitimi dhe asfaltimi i rruges"Mulliri i kuq" te Ura e Kovaçecit | 437m |
| 2 | Asfaltimi i rrugës "Hamit Berisha" në lagjen Berishë-Koxhaj | 195m |

| | | |
|---|---|---|
| 3 | Asfaltimi i segmentit të rrugës "Fadil Bunjaku"-Biqec | 102m |
| 4 | Zgjërimi dhe asfaltimi i rrugës "Hetem Hasaj"-Gabrricë-Bajnicë | 530m |
| 5 | Ndërtim me kubëza i rrugës "Ramë Luzha"-Begracë | 138m |
| 6 | Asfaltim i rrugicës "Ukshin Elezi" - Sllatinë | 250m |
| 7 | Asfaltim i degëzimit të rrugicës "Shaban Elezi"- Sllatinë | 68m |
| 8 | Asfaltim i rrugicës "Halilaj"- lagjja Halilaj-Sllatinë | 290m |
| 9 | Asfaltim i rrugës Begracë-Verban (segmenti i pjesës së Begracës) | 143m |
| 10 | Ndërtimi me kubëza i rrugës "Lepenci"-Kaçanik | 275m |
| 11 | Asfaltimi i rrugës në lagjen Teneqja-Stagovë | 1392m |
| 12 | Asfaltimi i rrugëve në lagjen Memaj-Dubravë<br>• Rruga "Kroji"<br>• Rruga "28 Nëntori"<br>• Rruga "Elmaz Mema"<br>• Rruga "Sinan Mema"<br>• Rruga "Emin Mema" | 348.50m |
| 13 | Asfaltimi i rrugës "Mbretresha Teuta"-K.Vjetër | 486.50m |
| 14 | Asfaltimi i rrugicës "Tahir Topalli"-lagjja Topalli | 186m |
| 15 | Asfaltimi i rrugicës "Rezistenca" Vishaj-Dubrave | 103m |
| 16 | Asfaltimi i rrugicës "Tahir Sinani" Vishaj-Dubrave | 65m |
| 17 | Asfaltimi i rrugicës "Nënë Tereza" Vishaj-Dubrave | 209.50 |
| 18 | Asfaltimi i rrugicës "Vatra Shqiptare" Vishaj-Dubrave | 61.50 |
| 19 | Zgjërimi i rrugës "Beteja e 25 Majit"-Dubrave | 66m |
| 20 | Shtrimi me kubëza i rrugicave në Doganaj<br>• Degëzim i rrugës "Kemajl Kolshi"<br>• Degëzimi I dhe II i rrugës "Izair Luma" | 282m |
| 21 | Asfaltimi i rrugës "Hamëz Jashari"-segmenti te Silcapori | 485m |
| 22 | Asfaltimi i rrugicës "Ramush Jaha"-Stagovë | 260m |

| | | |
|---|---|---|
| 23 | Asfaltimi i segmentit të rrugës "Idriz Seferi"-Kaçanik | 71m |
| | **Totali** | **6444m** |
| | **Rehabilitim i rrugicave me zhavor** | |
| 1 | Ndërtimi i rrugicave në fshatin Nikaj-përgatitje e traseve/ zhavor | 581.50m |
| 2 | Ndërtimi i rrugicave në lagjen Baftijaj-Dubravë/ zhavor | 138m |
| 3 | Ndërtim i rrugës "Mynyr Thaqi"-Kovaçec/zhavor | 141m |
| 4 | Rehabilitimi i rrugës "Veteranet e UÇK-së-Ivajë/ zhavor | 370m |
| | **Totali** | **1230.50** |
| | | |
| | **Ndërtim i shtretërve të përrockave** | |
| 1 | Rregullimi shtratit të përroit të lagjes Koraqi-Kovaçec | 70m |
| 2 | Ndërtimi i shtratit të përrockes në fshatin Gajre | 53m |
| | **Totali** | **123m** |
| | | |

Projekte dhe punë të tjera të kryera apo që janë duke u kryer nga DUKMM:

- Ndërtimi dhe rregullimi i Çarshisë së Vjetër të Qytetit (Kontrata eshte dyvjeçare, vazhdon edhe ne vitin 2022)
- Rrenimi i objekteve dhe largimi i deponive ilegale
  Është rrënuar një objekt në rrugën "Avdurrahim Shehu" dhe janë larguar 14 deponi ilegale
- Renovimi i objekteve banesore kolektive
  Është kryer renovimi i ndërteses se Vjetër P+8, përkatësisht është rehabilituar fasada e saj.

Sektori i Kadastrit

Gjatë vitit paraprak pranë sektorit të kadastrit kemi pranuar dhe janë regjistruar 6284 lëndë, ku nga ky numër janë zgjidhur 6188 ndërsa në pritje për ekzekutim janë edhe 96 lëndë kryesisht të RDPP-së që kanë të bëjnë me bartje të pronave si dhe legalizime të objekeve të pranuara nga ana e palëve fizike apo juridike.

Ky sektor ka vazhduar me përpikmëri të bëjë implementimin e ligjit mbi themelimin e Regjistrit të të Drejtave të Pronës së paluajtshme Nr. 2002/5 dhe plotësimit të tij Nr.2003/13, si dhe ligjit mbi hipotekat Nr.2004/4.

Nga lëndët sa u përket Çertifikatave, Fletët Poseduese, Kopjet e Planit, Kordinatave gjeodezike etj të gjithat janë të kryera dhe të dorëzuara brenda afatit ligjor përkundër fluksit të madh të kërkesave nga palet përfshir kryesisht mërgimtaret që don të thot se nuk ka pasur ngecje në punë dhe palët kanë qenë të shërbyer në afatin optimal.

Në vazhdim kemi paraqitur llojet dhe sasin e kërkesave për secilen kategori veç e veç të cilat gjatë ekzekutimit në total kan gjeneruar të hyra afërsisht në shumën prej 80,000 € (euro) dhe atë:

= Sherbimet e ofruara sipas kërkesave të palëve:

- Fleta poseduese 2553 lëndë
- Kopje të planit 997 lëndë

- Çertifikata të gjendjes së pasurisë 724 lëndë
- Koordinata gjeodezike 649 lëndë
- Identifikime 00 lëndë
- Të ndryshme (AKP, Gjykatat, K.K Kaçanik etj.) 41 lëndë
- Regjistri i RDPP-së 1320 lëndë

KAÇANIKU

= Regjistri i RDPP-së :

| Lloji I Lendes ne RDPP | Totali |
|---|---|
| Bartja e posedimit - Ndarje fizike e pasurise | 7 |
| Bartja e posedimit - Blerje | 200 |
| Bartja e posedimit - Dhurim | 334 |
| Bartja e posedimit - Këmbim | 7 |
| Bartja e posedimit - Në bazë të pranimit | 1 |
| Bartja e posedimit - Shpronësim | 4 |
| Bartja e posedimit - Trashëgimi | 102 |
| Bartja e posedimit Aktgjykim dhe fitime tjera të posedimit | 18 |
| Bartja e posedimit -Ndërtimit/kompensim | 2 |
| Bartja e pronësisë - Blerja | 33 |
| Bartja e pronësisë - Dhurata | 1 |
| Bartja e pronësisë - Këmbimi | 1 |

| | |
|---|---|
| Bartja e pronësisë - Trashëgimia | 2 |
| Bartja e pronësisë Aktgjykim dhe fitime tjera të pronësisë | 1 |
| Bashkimi I parcelave | 99 |
| Bashkimi i personave të njejtë me ID te ndryshme | 27 |
| Bashkimi i personave të njejtë me ID te ndryshme pa njësi | 1 |
| Fshirja e hipotekës pas skadimit të afatit | 28 |
| Fshirja e njesise Kadastrale | 2 |
| Fshirja e qiramarrjes sipas marrëveshjes | 1 |
| Fshirja e vërejtjes me kërkesë të palës | 1 |
| Fshirja e vërejtjes me vendim të gjykates | 1 |
| Fshirja e vërejtjes pas skadimit të afatit | 1 |
| Modifikimi i hipotekës | 4 |
| Modifikimi i të dhënave të personit pa njësi kadastrale | 43 |
| Modifikimi i të drejtave | 4 |
| Ndarja e parcelave | 305 |
| Ndarja e pjesës së ndërtesës | 1 |
| Regjistrimi i hipotekës | 28 |
| Regjistrimi i ndërtesës (perfshire kryesisht Legalizimet) | 40 |
| Regjistrimi i pjesëve të ndërtesës | 3 |
| Regjistrimi i qiramarrjes/nënqiramarrjes | 6 |
| Regjistrimi i servitutit | 2 |
| Regjistrimi i të drejtës së shfrytëzimit | 5 |
| Regjistrimi i vërejtjes me kërkesë të palës | 3 |

| | |
|---|---|
| Regjistrimi i vërejtjes me vendim të gjykates | 1 |
| Regjistrimi i vërejtjes sipas kërkesave tjera | 1 |

Është vazhduar me Implementimin e Kadastrit digjital, ku është punuar në barazimin e pjesës grafike të Operatit Kadastral me atë tekstual.

Gjithashtu gjatë viti paraprak kemi implementuar edhe Udhëzimin Administrativ nr.03/2016 për Masat e Veçanta për Regjistrimin e Pronës së Paluajtshme së Përbashkët në emër të dy bashkshortëve. Ku përmes këtij udhëzimi bashkëshortët të cilët kanë shpreh vullnet që të regjistrojn pronën e paluajtshme si pasuri të përbashkët kanë qenë të liruar nga pagesa e taksave pranë zyreve kadastrale komunale. Ky udhëzim ka filluar te implementohet nga marsi i vitit 2016 deri më mars të vitit 2017, dhe me vendim të Qeverisë së Kosovës ky afat është zgjatur edhe për një viti nga prilli i viti 2017 deri ne vitit 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

Është vazhduar me bashkëpunim me Agjencionin Kadastral të Kosovës në eleminimin e gjitha problemeve që kanë dalë gjatë punës së përditshme profesionale në këtë sektor, gjithashtu ky bashkëpunim është bërë edhe sa i përket trajnimit të mëtutjeshëm të personelit që është i angazhuar në kuadër të këtij sektori.

Në aspektin profesional është përkrahur Kuvendi Komunal në punët e shumë komisioneve siq janë: Komisioni për pranime teknike të projekteve, vlersimin e ofertave, etj.

Gjithashtu asistenca dhe bashkëpunimi professional nuk ka munguar dhe ndaj institucioneve shtetërore siç janë: Agjencioni Kosovar i Privatizimit, Ministria e

Infrastrukturës etj, ndërsa me informacione të ndryshme sipas kërkesës është përkrahur edhe Gjykata Komunale.

Sektorinë për qështje pronësore-juridike gjatë periudhës raportuese është marrë me punët dhe detyrat që i takojnë këtij Sektori dhe atë nga lëmia e uzrpimit arbitrar të Pronës Komunale dhe asaj publike, Shpronësimit, Mbajtjes së evidences së Pronës Komunale si dhe mënyrat e rregullimit të mardhënjeve pronësore-juridike, informata dhe raporte për organe të ndryshme.

Në kuader të legalizimeve kemi vazhduar me procesin e legalizimt te objekteve-ndërtesave dhe ekzekutimin e tyre në planet digjitale kadastrale dhe pjesen tekstuale te SIKTK-së sipas ligjit dhe akteve te tjera ligjore ne fuqi mbi Legalizimet.

## DREJTORIA E SHËNDETËSISË DHE MIRËQENIES SOCIALE

Periudha një vjeqare janar deri dhjetor 2021 për Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale ka qenë vit I angazhimit dhe perkushtimit maksimal në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve në fushën e kujdesit parësor shëndetësor, shërbimeve sociale.

Në këtë raport zyrtar janë përfshirë të gjitha aktivitetet e zhvilluara në periudhen e lartëcekur në fushën Shëndetësis dhe Mireqenjes Sociale.

PUNËT E KRYERA GJATË VITIT 2021

Blerja e aparatit full automatik biokimik dhe pajisjeve tjera laboratorike

Rindërtimi I objektit të QMF-së në Doganaj
Faza e dytë e rrethojave të QKMF-së.
Blerja e monitorëve, llaptopëve, blerja e baterive për aparatin e rëntgenit
Furnizimi me barna dhe material shpenzues mjekësor.
Furnizimi me material për stomatologji, laborator dhe filma të rëntgenit.
Furnizimi me material administrative shëndetësor.
Jane ndihmuar 30 familje me mjete financiare ku vlera ka qen 5000 euro
Jane ndihmuar 320 familje me pako ushqimore
Jemi ne fazen e perfundimtare te baneses per banim sociale.

KAÇANIKU

Puna gjatë vitit 2021 ka shkuar mire,.punëtorët kanë respektuar orarin dhe diciplinën në punë,të gjitha shërbimet shëndetësore ndaj qytetarëve janë kryer në të gjitha njësitë organizative të QKMF-së.
Gjatë vitit 2021, janë mbajtur takimet e rregullta mujore të Këshillit Profesional dhe Këshillit Drejtues, me ç` rast janë diskutuar çështje të ndryshme profesionale, si dhe çështje të tjera organizative që ka të bëjë me funksionimin më të mire të punës në QKMF.
Vizitat shtëpijake për te të sëmurët në stadin terminal të kancerit,si dhe te të sëmurët e palëvizshëm ,si dhe vizitat shtëpijake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç janë realizuar gjatë vitit 2021 nga ana e ekipeve tona mjekësore. Poashtu edhe ligjëratat në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional janë mbajtur për mjekë dhe infermierë gjatë vitit 2021. Gjatë vitit 2021 kemi pasë përkrahje të jashtëzakonshme nga institucionet komunale dhe Ministria e Shëndetësisë dhe kjo ka bërë që ne si QKMF ti kryejmë të gjitha shërbimet shëndetësore ndaj qytetarëve dhe nuk kemi pasë kurrfarë pengese në punën tone . Gjatë vitit 2021 kemi pasë bashkëpunim me të gjitha organizatat qeveritare dhe joqeveritare, FSK-në,si dhe KFOR-in amerikan dhe Polak. Poashtu gjatë këtij viti kemi pranuar donacione nga organizata, si dhe individ nga diaspora të cilët jashtëzakonisht na kanë lehtësuar punën tonë . Gjatë vitit 2021

**JANAR 2021**

Puna gjatë muajit janar, ka shkuar mire,punëtorët respektojnë orarin dhe diciplinën në punë,të gjitha shërbimet shëndetësore ndaj qytetarëve kryhen .
Në muajin janar është mbajtur takimi i rregullt i Këshillit Profesional dhe Këshillit Drejtues,me ç` rast është diskutuar për situatën epidemiologjike me coronavirus,si dhe masat që duhet të ndërmirren për përballimin e pandemisë së coronavirusit nga ana e QKMF-së,si dhe zbatimin me rigorozitet të rekomandimeve nga ana e Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës dhe Ministrisë së Shëndetësisë.
Vizitat shtëpijake për te të sëmurët në stadin terminal të kancerit,si dhe te të sëmurët e palëvizshëm kanë vazhduar edhe në muajin janar ,kurse vizitat shtëpijake për nëna dhe fëmijë nga mosha 0-3 vjeç janë ndërprerë,por këshillat ju jepen përmes komunikimit virtual(viberit) dhe ky organizim është bërë për shkak të pandemisë së coronavirusit..
Gjatë muajit janar, kane marre sherbime shendetesore pacientët me Covid-19,si dhe pacientët e dyshuar me Covid-19, ne hapesiren e cila eshte caktuar te Mjekesia Familjare
Vlen të theksohet se ekipet tona mjekësore kanë bërë vizitat mjekësore te familjartë e të prekurve me Covid-19,ku ju janë dhënë këshilla mjekësore,si dhe është kërkuar që familjartë të izolohet për 14 ditë dhe në qoftë se manifestojnë simptome, të lajmërohen permes telefonit QKMF-në. Gjate

muajit janar. kemi pase rritje te rasteve të numrit te pacienteve me Covid-19 dhe te cilet marrin sherbim ne QKMF.por perkunder kesaj situate me pandemine COVID-19 . gjendja eshte e menagjueshme.

Në muajin janar në QKMF dhe terren janë kryer 9707 shërbime shëndetësore.Prej tyre janë kryer **5988** kontrolla mjekësore.janë referuar për në spital **493** raste. në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **2076** pacientë.injeksione **3456**.infuzione**1628**.lidhje dhe pastrim të plagëve **641**. janë bërë **101** Ekg-ja.inhalime **28** .janë realizuar **181**vizita shtëpijake .triazhime **2536**.përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **562** që janë realizuar në QKMF.njesia e vaksinimit **356**.si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **150**.në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **534** pacientë.në njësinë e röntgenit kanë marrë shërbime **369** pacientë.

Problem vazhdon të mbetet mosmbajtja e kujdestarisë nga ana e barnatoreve.si dhe furnizimi jo i mjaftueshëm me barna dhe material shëndetësor nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

Me daten 06 janar kemi pranuar nga UNICEF-i donacion dezinfektues për duar me senzor .Poashtu me daten 26 janar kemi pranuar donacion nga CDF-ja pajisje mbrojtëse mjekësore për punëtorët shëndetësor të QKMF-së .

.Gjate muajit shkurt. kemi pase rritje te rasteve të numrit te pacienteve me Covid-19 dhe te cilet marrin sherbim ne QKMF.por perkunder kesaj situate me pandemine COVID-19 eshte e menagjueshme.

Në muajin shkurt në QKMF dhe terren janë kryer **9713** shërbime shëndetësore.Prej tyre janë kryer **6308** kontrolla mjekësore.janë referuar për në spital **657** raste. në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **1793** pacientë.injeksione **3354**. infuzione **1281**. lidhje dhe pastrim të plagëve **559**. janë bërë **154** Ekg-ja.inhalime **467**, janë realizuar **185** vizita shtëpijake .triazhime **2974**. përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **507** që janë realizuar në QKMF.njesia e vaksinimit **939**. si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **151**. në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **650** pacientë.në njësinë e röntgenit kanë marrë shërbime **405** pacientë.

Ministria e Shëndetësisë 2000 teste rapide për Covid-19. Këto teste do të shfrytëzohen për testimin e qytetarëve tanë për COVID-19 .

Po kete muj kemi pranuar donacion 30 batanije për nevojat e pacientëve tanë nga një bashkëatdhetare e jona nga Gjakova

Donacioni tjeter me batanije për pacientët e qendrës sonë në vlerë prej 430 € nga një bashkëatdhetar i yni nga Isniqi i Deçanit.

Kemi pranuar donacion 2000 maska kirurgjike për personelin shëndetësor nga firma që punon dhe vepron në diasporë.. Vëllezërit Nuha" nga Ferizaj.

Poashtu gjatë muajit shkurt kemi pranuar donacion një karrocë invalidore për nevojat e pacientëve të QKMF-së nga Bashkim Baftiu.

Gjate muajit mars. kemi pase rritje te rasteve të numrit te pacienteve me Covid-19 dhe te cilet marrin sherbim ne QKMF.por perkunder kesaj situate me pandemine COVID-19 eshte e menagjueshme.

Në muajin mars në QKMF dhe terren janë kryer **15969** shërbime shëndetësore.Prej tyre janë kryer **8104** kontrolla mjekësore.janë referuar për në spital **1280** raste. në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **2063** pacientë.injeksione **4163**. infuzione**1800** .lidhje dhe pastrim të plagëve **658**. janë bërë **174** Ekg-ja.inhalime **112**. janë realizuar **149** vizita shtëpijake .triazhime **2613**, përshkrime dhe intervenime mjekësore nga

ordinancat private dhe spitalet **1222** që janë realizuar në QKMF.njesia e vaksinimit **1242**.si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **170**.në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **773** pacientë.në njësinë e rëntgenit kanë marrë shërbime **505** pacientë. Gjate muajit mars jane kryer testimet per Covid-19. me teste rapide ku jane testuar **551** qytetarë.kurse kane rezultuar pozitiv - **81** qytetarë.

..

Gjate muajit prill. kemi pase rritje te rasteve të numrit te pacienteve me Covid-19 dhe te cilet marrin sherbim ne QKMF.por perkunder kesaj situate me pandemine COVID-19 eshte e menagjueshme.

Në muajin prill në QKMF dhe terren janë kryer **8668** shërbime shëndetësore.Prej tyre janë kryer **5676** kontrolla mjekësore.janë referuar për në spital **224** raste. në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **2247** pacientë.injeksione **1750**.infuzione**1259** .lidhje dhe pastrim të plagëve **644**. janë bërë **167** Ekg-ja.inhalime **80**. janë realizuar **155** vizita shtëpijake .triazhime **3228**.përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **938** që janë realizuar në QKMF.njesia e vaksinimit **220**.si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **36**. në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **640** pacientë.në njësinë e rëntgenit kanë marrë shërbime **260** pacientë. Gjate muajit prill jane kryer testimet per Covid-19. me teste rapide ku jane testuar **594** qytetarë. kurse kane rezultuar pozitiv - **100** qytetarë.

Me daten 07 prill 2021 ka filluar vaksinimi kunder COVID-19. ku se pari jane vaksinuar punetoret shendetesor per te vazhduar me moshat mbi 85 vjeç. 80 -85 vjeç . 75 deri 79 vjeç . Numri i te vaksinuarve gjate muajit prill 2021 mbi 420 .te gjitha vaksinat jane shfrytezuar dhe asnje prej te vaksinuarve nuk ka pase efekte anesore dhe gjendja e tyre eshte e shkelqyeshme .

Në muajin maj. kemi rënie të numrit të infektuarve me Covid-19 .Numri total i te infektuarve.që nga fillimi i pandemisë 756 .të shëruar 728 . raste aktive 1 !

Gjate muajit prill. kemi pase rritje te rasteve të numrit te pacienteve me Covid-19 dhe te cilet marrin sherbim ne QKMF.por perkunder kesaj situate me pandemine COVID-19 eshte e menagjueshme.

Ne fillim te muajt maj 2021 Bujar Bela ka dhuruar barna dhe material shpenzues mjekesor per QKMF-në .në vlerë prej 1.000 €..

Po kete muaj .Leutrim Muhaxheri ka dhuruar nje manometer .aparat per matjen e presionit te oksigjenit.

Avni Tali ka dhuruar per QKMF-ne 2 karroca per pacientët e qendrës sonë mjekësore.

Në muajin maj në QKMF dhe terren janë kryer **9369** shërbime shëndetësore. Prej tyre janë kryer **6480** kontrolla mjekësore.janë referuar për në spital **533** raste. në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **2543** pacientë.injeksione **3451**.infuzione**1363** .lidhje dhe pastrim të plagëve **845**. janë bërë **135** Ekg-ja.inhalime **20**.janë realizuar **161** vizita shtëpijake .triazhime **2654**.përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **423**që janë realizuar në QKMF.njesia e vaksinimit **997**. si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **30**. në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **506** pacientë.në njësinë e rëntgenit kanë marrë shërbime **318** pacientë.

Numri i te vaksinuarve gjate muajit maj 2021 - **1126** , dhe asnje prej te vaksinuarve nuk ka pase efekte anesore dhe gjendja e tyre eshte e shkelqyeshme .

Problem vazhdon të mbetet mosmbajtja e kujdestarisë nga ana e barnatoreve.si dhe furnizimi jo i mjaftueshëm me barna dhe material shëndetësor nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë.

Në muajin qershor, kemi rënie të numrit të infektuarve me Covid-19 , numri total i të infektuarve që nga fillimi i pandemisë Covid-19 - 758, të shëruar 731 kurse nga data 30 qershor raste aktive 0

Si gjdo muaj edhe ne kete muaj qershori kemi pranuar donacion nga z.Avni Tali 7 karroca për nevojat e pacientëve të qendrës sonë mjekësore.

Jan pranuar donacion 35 pako higjenike për fëmijë nga Unicefi,ku ato pako janë shpërndarë nga ana e infermiereve që realizojnë programin për vizita shtëpijake për nëna dhe fëmijë ngas mosha 0-3 vjeç.

Jane pranuar donacion nga UNMIKU – 5000 maska për personelin shëndetësor të QKMF-së .

Në muajin qershor në QKMF dhe terren janë kryer **9946** shërbime shëndetësore.Prej tyre janë kryer **6450** kontrolla mjekësore,janë referuar për në spital **540** raste, në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **2197** pacientë, injeksione **3879**,infuzione**1239** ,lidhje dhe pastrim të plagëve **1065**, janë bërë **183**Ekg-ja,inhalime **43**,janë realizuar **204** vizita shtëpijake ,triazhime **2728**,përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **137** që janë realizuar në QKMF,njesia e vaksinimit **1467**,si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **113**,në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **654** pacientë,në njësinë e rëntgenit kanë marrë shërbime **332** pacientë. Që nga data 15.06.2021 ka filluar vaksinimi masiv i qytetarëve kundër Covid-19,kurse për të ndihmuar këtë proces Ministria e Shëndetësisë ka rekrutuar 5 infermiere ,si dhe ka angazhuar 2 specializantë për QKMF-Kaçanik në mënyrë ,që procesi i vaksinimit të shkojë sipas dinamikës së paraparë !

Numri i te vaksinuarve gjate muajit qershor 2021 - **1467** , dhe asnje prej te vaksinuarve nuk ka pase efekte anesore dhe gjendja e tyre eshte e shkelqyeshme .

Ne muajin korrik kemi pranuar donacion- 37 leukoplasta për nevojat e QKMF-së nga bashkëatdhetari ynë z.Fadil Azemi .

kemi pranuar donacion barna dhe material shpenzues mjekësor nga bashkëatdhetari ynë z.Bujar Bela në vlerë prej 1.000 €.

Një bashkëatdhetar nga Franca,i cili dëshiron të mos ju publikohet emri ,dhuroji për QKMF-në 8 palë paterica.

FSK-ja ka dhuruar për QKMF-në 12.000 maska mbrojtëse të llojit FFP2 .

Shefqet Bekteshi ka dhuruar për QKMF-në 1000 elektroda për aparatin e EKG-së .

Gjatë muajit korrik 2021 janë realizuar **9542** shërbime shëndetësore. vizita mjekësore **7502**, referime **724**, injeksione **2781**, infuzione **1449**, lidhje dhe pastrim **1101**, EKG **310**, inhalime **29**, vizita shtëpijake **177**, triazhime **2543**, urgjenca **2991**, njësia e rëntgenit **354**, stomatologjia **94**, laboratori **668** .

Furnizimi me barna nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë ka qenë simbolik.

.

Gjatë muajin gusht 2021 .sidomos prej datës 14 gusht kemi pasë rritje të rasteve me Covid-19 si pasojë e vales së re me Variantin Delta .ku kemi pasë qindra qytetarë të prekur me Covid-19 e poashtu kemi pasë edhe raste të vdekjes me variantin delta të Covid-19 edhe atë në mesin e të rinjëve – 2 raste . mosha 18 dhe 23 vjeç nga komuna jonë . Numri i përgjithshëm i rasteve pozitive me Covid-19. që nga fillimi i pandemisë 1163. të shëruar 814 . raste aktive 320. të vdekur 27 .

Gjatë muajit gusht 2021 janë realizuar **14306** shërbime shëndetësore. vizita mjekësore **10374**. referime **640**, injeksione **3372**, infuzione **3028**. lidhje dhe pastrim **971**, EKG **503**, inhalime **47**. vizita shtëpijake **240**, triazhime **4343**, urgjenca **3817**. njësia e rëntgenit **518**, stomatologjia **73**, laboratori **774** .
Furnizimi me barna nga lista esenciale e Ministrisë së Shëndetësisë ka qenë simbolik. Problem paraqet mosmbajtja e kujdestarisë nga ana e barnatoreve.kjo situate është ngarkesë shtesë për stafin shëndetësor që punon në ndërrimin e natës !

Me datën 14 shtator 2021 kemi ndërpre kryerjen e testimeve rapide për Covid-19 . për shkak të mungesës së materialit për testim .
Prej datës 26 shkurt 2021 deri me datën 13 shtator 2021 në QKMF-Kaçanik janë kryer mbi 6000 testime për Covid-19.
Ne kemi proceduar me kërkesë për furnizim me teste rapide në Ministri të Shëndetësisë dhe në momentin që do të furnizohemi do të vazhdojmë me kryerjen e këtyre testimeve.
Gjatë muajit shtator kemi pranuar donacion nga Fevzi Shehu barna dhe material shpenzues .nga Dr.Astrit Sokoli dorëza .si dhe nga një qytetar I cili ka kerkuar të mbetet anonym disa barna për nevojat e pacientëve të qendrës sonë mjekësore.
Procesi vaksinimit po ecën mbarë. deri me datën 30.09.2021 janë administruar 23.738 doza të vaksinës anticovid.
Në muajin shtator në QKMF dhe terren janë kryer **10629** shërbime shëndetësore.Prej tyre janë kryer **7537** kontrolla mjekësore.janë referuar për në spital **453** raste. në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **2007** pacientë.injeksione **2991**. infuzione **1691** ,lidhje dhe pastrim të plagëve **699**, janë bërë **163** Ekg-ja.inhalime **52**,jànë realizuar **249** vizita shtëpijake , triazhime **3596**. përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **587** që janë realizuar në QKMF. njesia e vaksinimit **375**.si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **106**. në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **776** pacientë.në njësinë e rëntgenit kanë marrë shërbime **497** pacientë.

Gjatë mujit tetor situata me Covid-19 ka qenë më e qetë. kurse prej datës 14 tetor 2021 nuk kemi më raste aktive me Covid-19 ( Zero raste aktive )
Procesi i vaksinimit gjatë muajit tetor ka shkua mbarë.
Me datën 27 tetor 2021 jemi furnizuar me vaksina kundër gripit sezonal – 3000 copë .

Në muajin tetor në QKMF dhe terren janë kryer **10.337** shërbime shëndetësore.Prej tyre janë kryer **6.581** kontrolla mjekësore,janë referuar për në spital **578** raste. në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **1981** pacientë.injeksione **3.724**.infuzione **1320** .lidhje dhe pastrim të plagëve **835**. janë bërë **208** Ekg-ja.inhalime **79**,janë realizuar **146** vizita shtëpijake .triazhime **2.903**.përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **652** që janë realizuar në QKMF.njesia e vaksinimit **1448**. si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **110**. në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **742** pacientë.në njësinë e rëntgenit kanë marrë shërbime **329** pacientë.
Gjatë mujit tetor situata me Covid-19 ka qenë më e qetë. kurse prej datës 26 nëntor 2021 nuk kemi më raste aktive me Covid-19 ( Zero raste aktive )

Gjatë muajit nëntor ka vazhduar vaksinimi i rregullt në terren .
Gjatë muajit nëntor kemi angazhuar ekipet mobile për vaksinim kundër COVID-19.si dhe vaksinimi kundër gripit sezonal sezonal .Poashtu vlen të theksohet se gjatë muajit nëntor kemi filluar vizitat sistematike për nxënësit prej parafillorëve deri në klasën e pestë .Kemi filluar me shkollën fillore të mesme të ultë.. Emin Duraku`` në Kaçanik .pastaj në shkollën fillore të mesme të ultë.. Idriz Seferi " në fshatin Bob dhe do të vazhdojmë edhe në shkolla të tjera të komunës sonë .nëse na lejon situate epidemiologjike me pandeminë Coivid-19 !
Kemi pranuar donacion 8 palë paterica dhe gaza sterile nga një bashkëatdhetari i ynë G.D.që jeton dhe punon në Francë . I njëjti bashkëatdhetar ka dhuruar në muajin korrik 2021 edhe 8 palë paterica. Me inciativë të mjekut tone Dr.Valon Livoreka.si dhe një bashkëatdhetari tone Yll Nika . diaspora jonë nga Holanda ka dhuruar mjete pune për punëtorët shëndetësorë . si dhe material shpenzues mjekësor për pacientët e qendrës sonë në vlerë prej 1500 € !

Në muajin nëntor 2021 në QKMF dhe terren janë kryer **11.908** shërbime shëndetësore. Prej tyre janë kryer **7.996** kontrolla mjekësore, janë referuar për në spital **616** raste. në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **2347** pacientë.injeksione **3.714**.infuzione **1782** .lidhje dhe pastrim të plagëve **860**. janë bërë **229** Ekg-ja.inhalime **153**,janë realizuar **180** vizita shtëpijake .triazhime **3.757**.përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **181**që janë realizuar në QKMF.njesia e vaksinimit **1135**.si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **139**.në laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **956** pacientë.në njësinë e rëntgenit kanë marrë shërbime **364** pacientë.
Furnizimi ana e Ministrisë së Shëndetësisë ka qenë më i mire në krahasim me periudhën e përparshme. Mungon vetëm materiali shpenzues mjekësor siç janë : shiringat 10 ml.sistemi i infuzionit.kanillat .si dhe vatat .

Familjartë e Azem Belës kanë dhuruar 55 sisteme të infuzionit.
Kemi pranuar donacion nga bashkëatdhetarja Blerina Burrniku teste rapide për Covid-19 .
Në muajin dhjetor 2021 në QKMF dhe terren janë kryer **16.703**shërbime shëndetësore.Prej tyre janë kryer **11,027** kontrolla mjekësore,janë referuar për në spital **1102** raste, në urgjencë kanë marrë shërbime mjekësore **3418** pacientë.injeksione **4.930**.infuzione **2518** .lidhje dhe pastrim të plagëve **733**. janë bërë **187** Ekg-ja,inhalime **156**,janë realizuar **85** vizita shtëpijake .triazhime **5250**.përshkrime dhe intervenime mjekësore nga ordinancat private dhe spitalet **1256** që janë realizuar në QKMF,njesia e vaksinimit **1135**.si dhe kontrolla mjekësore stomatologjike **131**.në

laborator kanë kryer analiza laboratorike dhe biokimike **1103**pacientë.në njësinë e rëntgenit kanë marrë shërbime **378** pacientë.

SHËRBIMET SHËNDETËSORE GJATË VITIT 2021

1.Mjekësia familjare ........................................90.023
2.Urgjenca ......................................................29.450
3.Stomatologjia ...............................................1303
4.Vizitat shtëpijake për nëna dhe fëmijë ........................1345
5.Vaksinimi ......................................................9.357
6.Laboratori ......................................................8776
7.Rëntgeni ......................................................4.287
8.Terreni ......................................................550
9.. Shërbimi infermierik ........................................ 268.848

Totali i shërbimeve shëndetësore në vitin 2021 .................. **413.939**

**Qendra per Pune Sociale**

Gjatë vitit 2021 Shërbimi profesional i Qendrës për Punë Sociale në Kaçanik është angazhuar në realizimin e programit të punës duke punuar në të gjitha format që kanë të bëjnë me mbrojtjen sociale. Gjatë kësaj kohe kemi zbatuar tërë ligjislacionin në fuqi që ka të bëjë me Shërbimin Social.

**Fëmijët pa kujdes prindëror:**

a) Fëmijët pa dy prindër
b) Fëmijët e braktisur
c) Prindërit e fëmijëve që nuk i kryejnë detyrat prindërore

| Fëmijët pakujdesin prindor | Nr. i fëmijëve/ mujori 2019 | Përzgjedhja e familjes | Kujdestari | Strehimi i | Strehimi familjar | Adoptimi | Referenca në | Pregaditja e strehimit | Përcjellja e fëmijëve Nën përkujdesje | Rastet në proces | Të mbyllura . | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Fëmijët pa dy prind | 7 | po | 7 | po | jo | jo | po | - | Të gith fëmijët janë përcjellur | jo | | 7 |
| Fëmijët e braktisur | jo | jo | jo | - | jo | jo | jo | - | | jo | | jo |
| Prindërit e fëmijëve që nuk i kryejn obligimet | 12 | po | | | | - | | - | jo | 7 | 5 | 12 |

Nga tabela e lartshënuar konstatojmë këtë:

<u>**Fëmijë të braktisur**</u> gjatë vitit 2021 nuk kemi pasur fëmijë të braktisur.

1

**Prindërit e fëmjëve të cilët nuk i kanë kryer detyrat prindërore**

**Fëmijët e familjeve në konflikt me ligjin:**

a) Keqtrajtimi i fëmijëve dhe lënja pas dore
b) Fëmijët e familjeve me mardhënje të çrregulluara
c) Fëmijët e prindërve të shkurërzuar

Tab. nr. 2

| Fëmijët e familjeve në konflikt | Ndërmjetësimi | Strehimi i Përkohëshëm i fëmijëve | Inicimi i procedurave Për marrjen e të drejtës prindore | Caktimi i kujdestarit | Bashkëpunimi Me institucionet tjera | Raste Në proces | Të Mbylura |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| a)Keqëtrajtimi dhe lënja pas dore | 5 | - | - | - | po | 3 | 2 |
| b) Fëmijët e familjeve me marrëdhënje të ç'rregulluara | 15 | - | - | - | po | 7 | 8 |

Gjatë këtij viti të 2021 jemi ballafaquar edhe me prindërit të cilët nuk kanë pasur kujdes ndaj fëmijëve të tyre.

Zyrtarët e Shërbimit Social janë marrë me përkujdesjen dhe përcjelljen e rastit, fëmijët janë vizituar dhe është biseduar me prindërit e tyre. Më lartë (tab.2) kemi paraqitur tabelën e kësaj forme të mbrojtjes sociale. Në këtë periudhë kohore jemi ballafaquar edhe me problemin e fëmijëve të familjeve me ç'regullime bashkëshortore ku ky numer i femijëve arrin në 15. Ndërsa, në trajtim të QPS nga Zyrtarët e Shërbimit Social këtyre fëmijëve iu është dhënë mendimi për besueshmërinë e njërit prind i cili ka aftësi për tu kujdesur për rritjen dhe zhvillimin normal të cilat janë kërkuar nga gjykata.

**Fëmjët dhe rinia me sjellje të ç'rregulluara**

| Fëmijet dhe rini me sjellje të çrregulluar | Puna me familje dhe fëmijë | Bashkpunimi me shkollë | Me policij | Me gjygj | Me OJQ | Propozimi i masës educative dhe | Përcjellja e mases educative dhe | Rastet në process të rij / të vetër | Të mbyllur | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| a)Fëmijët me sjellje asoiale të mosh. 14 | 5 | 5 | po | po | po | 3 | po | 3 | 1 | 6 |
| b) Rinia me sjellje asociale 14-18 | 15 | 10 | - | po | po | - | - | - | 9 | 15 |
| Delikuentët e ri prej 14-16 v. | Për vitin 2021 25 | po | po | po |  | po | po |  | po | 25 |
| Delekkuentët e rritur 16-18 | 30 | po | po | 15 |  | po | po |  | po | 30 |

Prej këtij numri të **55** delekuentëve, **15** kanë kryar vepra penale, **45** kanë kryer vepra kundërvajtëse. Struktura gjinore e tyre është 50 mashkuj dhe 5 femra.

**Nga ky numër i delekuentëve kemi 10 përsëritës të veprave( Recidevista).**

Masa të shqiptuara ndaj këtyre delekuntëve kemi : 35 delekuent kanë masën edukative- **Kujdesi i shtuar prindëror,** 20 delekuent kanë masën - **Kujdesin e shtuar të organit të kujdestarisë . Të tjerat janë në procese të gjykateve. Në rastet e delekuentëve Zyrtarët e Shërbimit Social kanë marr pjesë gjatë intervistimit nga ana SHPK-së Kaçanik në 40 raste në kohë të ndryshme.**

**Strehimi në strehimore**

Gjatë kësaj periudhe kemi patur 3 raste të strehuara në strehimore në Ferizaj.

Qëndrimi tyre ka qenë deri në tri ditë dhe 2 javë.

## Fëmijët me aftësi të kufizuara të përherëshme ( FAKP )

| Fëmijët dhe të rinjët me nevoja të veçanta | Identifikimi i rastit | Puna me fëmijë | Puna me prindër | Ndihma dhe udhëzimet profesionale lidhur me | Bashkpunimi me instucionet tjera | Bashkpunimi me OJQ | Rastet në proces | Të mbyllura | Total |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| a) Psiqike 20 | po | po | po | po | po | po | | | 20 |
| b) fizike 15 | po | | po | po | po | - | | | 15 |
| c) të kombinuara 13 | po | po | po | po | po | po | | | 13 |

Në këtë kategori të fëmijëve me aftësi të kufizuese të përherëshme kemi evidentuar dhe i kemi udhëzuar që të gjejnë shërbim adekuat në institucionet përkatëse ,njëkohësishtë i kemi udhëzuar lidhur me mundësinë e edukimit dhe arsimimit në shkolla speciale.

48 fëmijë iu është e njohur nga komisioni mjekësor e drejta për ndihmë materiale për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara në bazë të Ligjit 022/09, ku prej tyre janë 18 femra dhe 30 mashkuj.

**Të rriturit me nevoja të veçanta** =

| Të rriturit me nevoja të veçanta | Identifikim i rasteve | Puna sociale me | Propozimi i marrjes të zotësi së | Caktimi i kujdestaRI | Ndima për të | Bashkpuni mi | Bashkpunu nimi me institucionet | Ndima për aftësim dhe | Në proces | Të mbyllura | Totali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| a)Psikike | Për vitin 2021 | 5 | - | - | - | po | po | - | | 5 | 5 |
| b)Fizike | 3 | 2 | - | 1 | | 3 | - | - | 2 | - | 3 |
| c)Psikike dhe fizike | 2 | 2 | - | 1 | - | 1 | po | - | 1 | - | 2 |

Në QPS, është evidentuar edhe kjo kategori e njerzëve ku një pjesë e tyre janë përfshirë në skemën e NS, një pjesë iu është ofruar shërbim social, ndërsa një pjesë ka mbetur pa u përfshirë në ndihmë sociale për shkak të kritereve të SNS .

QPS- në Kaçanik këtë kategori vazhdimisht e ka këshilluar, orientuar që të vizitojnë qendrën mentale në Ferizaj ku një numër i tyre janë klientë të rregullt të kësaj qendre.

Me aplikimin e ligjit për personat me aftësi të kufizuara kemi një rënje të tyre.

**Të rriturit me gjendje konfliktuoze**

| | Identifikimi | Ndërmjetsimi | Trajtimi psiko social | Bashkpunimi me policin | Me gjygjin | Me OJQ | Ra stet në proces | Të mbyllura | Tatali |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Të rriturit me raporte të qrregulluar familjare | Për vitin 2021 | 7 | | po | po | po | 4 | 3 | 7 |
| Dhuna në familje | 10 | 5 | - | po | po | po | 7 | 3 | 10 |
| Personat e rritur në kontest të shkurorzimit | 8 | 1 | - | po | po | po | 6 | 2 | 8 |

Në këtë periudhë vjetore i kemi pasur 10 raste (çifte bashkëshortore) në kontest shkurorëzimi.

Kemi pasur 5 kontaktime të fëmijëve me prindërit që janë procedur ligjore, prej këtyre kontakteve kemi pasur 9 fëmijë.

**Të rriturit me sjellje asociale**

| Të rriturit me sjellje | Identifikimi | Trajtim social | Bashkpunim | Policija | Gjygj | OJQ | Rastet në proces | Të mbylura | Tatal |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Endacakët | Për vitin 2021 | po | po | po | po | po | 2 | 1 | 3 |

| | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Alkolistët | | | | | | | | | |
| Narkomanë t | - | - | - | - | - | - | - | - | |

KAÇANIKU

**Trafikimi i qenjeve njerzore**

Gjatë këtij viti 2021 Shërbimi social nuk kemi asnjë rast të trafikimit, as të miturve ,por as të rriturëve që është indentifikar nga shërbimi social

**Adoptimi ( Birësimi )**

Në vitin 2021 kemi vetëm një adoptim e që është në process të gjykatës por, nga vitet e më herëshme kemi 10 kërkesa nga gjykata për adoptim, prej tyre e kanë përcaktuar edhe gjininë e fëmiut, 4 kanë kërkuar femra dhe 6 mashkuj.

**Strehimi familjar tek të afërmit**

**(Fëmijët pa dy prind)**

Kemi 7 fëmijë pa dy prindër të cilët me Ligjin e Familjes me nr. 2004/32 marrin nga 100 € në muaj deri në moshën 18 vjeç.

Këta fëmijë të gjithë kanë Kujdestar Ligjor.

**Shërbime tjera administrative**

Në këtë 2021 QPS-ja gjegjësishtë Organi i Kujdestarisë ka lëshuar vërtetime të ndryshme si për zotësi të veprimit dhe dhe vërtetime për lirimin nga shtetësia e Kosovës , si dhe vërtetimet për kujdestari që nuk kanë obligime financiare ndaj familjes dhe personave të tjerë. Kemi patur 7 raste të pranimit të atësisë dhe amsisë.

**Strehimi rezidencial**

Gjatë kësaj periudhe raportuese shërbimi social ka një klient në strehimin rezidencial gjegjësishtë në Institutin Special në Shtime.

Gjithnjë për punën dhe angazhimin tonë,për vështërisitë të cilat janë paraqitur kemi bashkëpunuar dhe konsulltuar me Divizinin e Shërbimeve Sociale pranë DPSF –së me ISP si dhe me Shëndetitn Mendor në Ferizaj . Në Institutin Special në Shtime është në tretman vetëm një klient.

Me respekt Drejtori I DSHMS Sali Malsiu

<u>**Drejtoria e Arsimit dhe Kulturës**</u>

## Organizimi i vitit shkollor në rrethana të krijuara nga pandemia

Pandemia COVID 19 e cila shpërtheu një vit më parë (në fillim të vitit 2020) e ka përcjellur vendin tonë edhe gjatë vitit 2021, duke krijuar një situatë të re edhe në

sistemin arsimor, ndërsa autoritet e shëndetit publik në bashkëpunim edhe me institucionet arsimore kanë ndërmarr një varg masash mbrojtëse anti COVID 19. Edhe gjatë këtij viti (2021), prioritet ishte ruajtja e shëndetit të fëmijëve/ nxënësëve, mësimdhënësve e stafit të shkollave, mirëqenies shëndetësore të tyre si dhe realizimi i procesit edukativo arsimor sipas kornizës së kurikulës së Kosovës, kurrikulave bërthamë për nivelet e arsimit parauniversitar, dhe zbatimin e plan-programeve mësimore.

Gjatë vitit 2021 të gjitha institucionet arsimore kanë funksionuar sipas skenarit A, pra me prani fizike në shkollë. Për të plotësuar ditët e mësimit sipas kalendarit shkollor, përfundimi i vitit mësimor u shty për disa ditë ndërsa me vendim të MASHTI-t fillimi i vitit shkollor 2021-2022 nuk ishte 1 shtatori si zakonisht por 27 shtatori 2021 për shkak të rritjes së numrit të të infektuarve në vend. Për të realizuar ditët e mësimit, MASHTI ka korrigjuar kalendarin shkollor të cilin e kemi realizuar me përpikmëri dhe me prezencë fizike të nxënësve në shkollë.

## Menaxhimi i pandemisë COVID 19

Në janar të vitit 2021, para fillimit të periudhës së dytë mësimore, në të gjitha shkollat është kryer dezinfektimi DDD dhe janë marrë të gjitha masat për ngritjen e nivelit të pastërtisë e higjienës së përgjithshme. Dezinfektimi është bërë për çdo fundjavë nga stafi ndihmës i shkollave, ndërsa për çdo muaj ka vazhduar të bëhet dezinfektimi i tërësishëm. Po ashtu, shkollat janë furnizuar me mjete higjienike si dezinfektues, sapun, e detergjente të tjerë, ndërkaq për secilën shkollë janë siguruar edhe maska mbrojtëse e termometra digjital për matjen e temperaturës për nxënës. Për të menaxhuar në mënyrë sa më të mirë situatën në shkolla, MAShTI ka publikuar një dokument (Udhëzuesi i përgjithshëm për organizimin e mësimit në kushte të pandemisë COVID 19) Edhe përkundër zbatimit të të gjitha masave anti COVID 19, megjithatë nuk kanë mbetur të paprekur nxënësit e as mësimdhënësit e punonjësit tjerë arsimor në Komunën e Kaçanikut. Numri i të infektuar me SARS-CoV-2, në asnjë moment nuk e ka arritur shifrën për të kaluar me mësim nga distanca.

## Masat e ndërmarra anti-COVID

Themelimi dhe funksionalizimi i Task Forcave në të gjitha shkollat dhe respektimi i Udhëzuesit të përgjithshëm për organizimin e mësimit në kushte të pandemisë COVID

19, sipas skenarëve A dhe B dhe C, duke vepruar në përputhje me udhëzimet e MAShTI-t dhe IKShP-së, përgatitja e hapësirave e dhomave mësimore për numër të përgjysmuar të nxënësve, për klasat me numër të madh nxënësish duke vendosur një nxënës në një bankë e po ashtu edhe shenjëzimi i hapësirave në korridore e hapësira të jashtme, ishin disa nga masat anti COVID. Parandalimi i përhapjes së virusit, përkatësisht respektimi i plotë i masave mbrojtëse anti COVID për mirëqenien , mbrojtjen, sigurinë dhe ruajtjen e shëndetit të nxënësve dhe stafit tjetër në institucione arsimore. Dezinfektimi permanent i hapsirave shkollore, mbajtja në nivel e higjenës, furnizimi me maska dhe bartja e tyre, mbajtja e distancës, kanë dhënë efektin e tyre, prandaj si rezultatet i kësaj, kemi arritur që procesin mësimor ta organizojmë sipas skenarit A – me praninë fizike të nxënësve në shkollë

## Gjithëpërfshirja e fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor

Gjithëpërfshirja ishte prioritet dhe synim për përfshirjen e gjithë nxënësve/fëmijëve në procesin edukativ arsimor, duke përfshirë edhe fëmijët me nevoja të veçanta.
Në këtë mënyrë, në institucionet tona arsimore është arrit shkallë e kënaqshme e gjithëpërfshirjes së fëmijëve në arsimin parashkollor dhe fillor duke përfshirë edhe ata me nevoja të veçanta, ndërkohë që pjesëmarrja/përfshirja e tyre duke mësuar së bashku me të tjerët e duke bashkëpunuar me bashkëmoshatarët dhe duke ndarë të njëjtat përvoja të të nxënit ka qenë vlerë e njëkohësisht edhe proces që ka ndihmuar fëmijët të njohin, pranojnë e vlerësojnë veten. Ndryshe, gjithëpërfshirja është e drejtë e çdo fëmije të ndjehet i respektuar, i sigurtë, i mbrojtur dhe të zhvillojë plotësisht potencialin e vet.

## Përmirësimi dhe avancimi i cilësisë në arsim

Gjatë vitit 2021 edhepse në rrethana pandemie, rëndësi e veçantë i është kushtuar përmirësimit dhe avansimit të cilësisë në arsim, bashkë me ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve por edhe përgjegjësinë në punë. Zbatimi i reformave në mësimdhënie dhe nxënie, me theks të veçantë zbatimin e Kurrikulës së re (Kurrikulës Bërthamë për Arsimin Parauniversita) dhe ofrimin e mundësisë që nxënësit e Komunës sonë të përfitojnë njohuri dhe kompetenca për të qenë konkurrent me bashkëmoshatarët e tyre në vend e më gjerë, i kanë kontribuar në masë të konsiderueshme përmirësimit dhe avansimit të cilësisë, mësimdhënies e mësimnxënies. Në kuadër të ngritjes së cilësisë në

arsim, gjatë vitit 2021 në sistemin arsimor komunal, janë sistemuar katër psikolge dhe dy padagoge të cilat janë shpërnda në shkolla në harmoni me numrin e nxënësve.

KAÇANIKU

## Vlerësimi i njohurive të nxënësve

Janë zbatuar standardet, respektivisht ka vazhduar vlerësimi i njohurive të nxënësve sipas kurrikulës së re i bazuar në rezultatet e të nxënësit për kompetenca, fushë kurrikulare dhe lëndë mësimore.

Vlerësimi i nxënësve sipas kërkesave kurrikulare është bazuar në rezultatet e të nxënit për kompetenca (RNK), rezultatet e të nxënit për fushë kurrikulare (RNF) dhe rezultatet e të nxënit për lëndë mësimore (RNL). Sipas Kornizës Kurrikulare qëllimi kryesor i vlerësimit është mbështetja e të nxënit të nxënësve dhe arritjet individuale të nxënësve, ndërsa Udhëzuesi për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë ka ofruar zgjidhje për vlerësimin e nxënësve në kushte pandemie.

## Vlerësimi i brendshëm dhe i jashtëm- Testi i Maturës dhe Testi i Arritshmërisë

Në afatin e parë, të mbajtur më 26 qershor 2021, gjithsej 357 maturant iu janë nënshtruar Testit të maturës 2021.

Në Gjimnazin "Skënderbeu" nga gjithsej 266 kandidatë, testin e maturës e kanë kaluar 209 prej tyre, apo 78,57 %, ndërsa në SHMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" , nga gjithsej 110 maturant të testuar, vetëm 27 prej tyre e kanë kaluar atë apo 24,55 %. Ndërkaq, nga të dhënat e publikuara, në këtë afat, del se në nivel komunal, kalueshmëria është 62,76 % . Ndërkaq në afatin e gushtit, nga gjithsej 83 maturant sa iu kanë nënshtruar testit, 42 prej tyre kanë arrit rezultat pozitiv. Në Gjimnazin

"Skënderbeu" nga gjithsej 34 maturant, testin e kanë kaluar 25 prej tyre (73,53%) e në ShMP nga 49 maturantë , atë e kanë kaluar 17 prej tyre ose 34,70 %. Në dy shkollat e mesme, mësimet i kanë vijuar 443 nxënës maturant, prej tyre 264 në Gjimnazin "Skënderbeu" dhe 179 në SHMP "Feriz Guri dhe vëllezërit Çaka".

Në Testin e arritshmërisë 2021, të mbajtur në qershor 2021, për nxënësit të cilët kanë përfunduar klasën e nëntë, Shkolla Fillore dhe e Mesme e Ulët " Qamil Ilazi" nga Kaçaniku i Vjetër ka arritur rezultatin më të mirë duke u radhitur e para me shkallë të kalueshmërisë prej 58,81 %. Shkolla e dytë është radhitur "Emin Duraku" nga Kaçaniku me 52,04 % , e treta "Kadri Zeka" nga Dubrava me 50,81 % , e katërta "Idriz Seferi" nga Bobi me 50,44 % etj. Ndërsa në nivel komunal është arritur kalueshmëria në shkallë prej 47,96 %.

Testit të arritshmërisë sivjet në komunën tonë iu kanë nënshtruar gjithsej 463 semimaturantë nga 12 shkolla fillore amë.

## Trajnimi i mësimdhënësve sipas fushave kurrikulare dhe furnizimi i shkollave me material pedagogjik dhe tekste shkollore

Trajnimet e mësimdhënësve për zbatimin e Kornizës Kurrikulare të Kosovës edhe gjatë vitit 2021 janë realizuar në funksion të ngritjes profesionale sipas fushave kurrikulare. Para fillimit të vitit shkollor, në muajin korrik 2021, për gjashtë ditë rresht, janë trajnuar 27 mësimdhënës të nivelit parafillor e fillor. DAK është e përkushtuar që vazhdimisht të identifikon nevojat e mësimdhënësve për trajnime, respektivisht zhvillimin profesional, ku përmes tyre synohet aplikimi i shkathtësive të reja, por edhe zhvillimin dhe e ngritjen profesionale të mësimdhënësve. DAK, fuqimisht mbështet përkujdesjen për ngritje të cilësisë në procesin mësimor, duke implementuar reformat në mësimdhënie dhe nxënie dhe ofrimin e mundësisë që nxënësit e komunës sonë të përfitojnë njohuri dhe kompetenca për të qenë konkurrent me bashkëmoshatarët e tyre ne vend e më gjërë.

DAK ka bërë përpjejkje për furnizimin me kohë të shkollave me materiale pedagogjike e materiale tjera të nevojshme, ndërkaq që me kohë janë shpërndarë edhe librat për nxënës të cilat edhe për këtë vit shkollor, qeveria e vendit, përmes MASHTI-it dhe shtëpive botuese të kontraktuara, i kanë furnizuar falas nxënësit për klasat 1 – V dhe VII e VIII pjesërisht, ndërsa jo edhe për nivelin parafillor dhe klasat VI, e IX.

## Funksionimi i organeve të shkollës

Këshilli Drejtues i Shkollës, Aktivet Profesionale, Task Forca në nivel shkolle e DKA, Koordinatorët e cilësisë, Këshilli i prindërve e Këshilli i nxënësve dhe Ekipet për Parandalim dhe Reagim ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit janë disa nga organet vendimarrëse dhe profesionale që janë funksionale në shumicën e shkollave tona. Ngritja e nivelit të përgjegjësisë, ndarja e punëve dhe përgjegjësive në përputhje me rolin dhe kompetencat e tyre len për të dëshiruar.

Koordinatorët e përzgjedhur janë angazhuar në sigurimin e cilësisë përmes procesit të planifikimit gjithëpërfshirës ku janë pasqyruar nevojat dhe prioritetet e shkollave dhe në përgjithësi zhvillimin e arsimit në përputhje me pandeminë, ndërsa një rol të rëndësishëm në planifikimin dhe monitorimin e procesit mësimorë, gjatë kësaj periudhe kanë pasur TASK Forca në nivel shkolle e DAK dhe po ashtu roli i tyre ka qenë edhe në krijimin e kushteve për zhvillimin e procesit mësimor në kohë pandemie COVID 19, edhe atë në distancë. Ekipet për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Braktisjes dhe Mosregjistrimit si mekanizëm parandalues është angazhuar për mundësi të barabarta për të gjithë për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mosregjistrimit në shkollë.

## Investimet në infrastrukturën shkollore dhe sportive

DAK gjatë vitit 2021 ka investuar në krijimin e kushteve sa më të mira për zhvillimin e procesit mësimor dhe ngritjen e cilësisë në arsim si dhe në zhvillimin e aktiviteteve kulturore dhe sportive. Segment i rëndësishëm është edhe ndërtimi i objekteve shkollore, zgjerimi i hapësirave dhe furnizimi me inventarë, kabinete shkollore e mjete të nevojshme për funksionimin e institucioneve shkollore.

Para fillimit të vitit shkollor janë kryer shumë renovime në objektet shkollore, ndërkaq është duke vazhduar ndërtimi i objektit të ri shkollor në fshatin Doganaj e po ashtu, janë duke u ndërtuar edhe sallat e edukatës fizike në ShMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" në Kaçanik dhe në ShFMU "7 Shtatori" në Begracë.

Vetëm për renovimin e objekteve shkollore për vitin 2021 janë shpenzuar 120,000 euro.

Në ShFMU "Emin Duraku" në Kaçanik në objektin e vjetër është bërë ngjyrosja e mureve të brendshme dhe rregullimi i dyshemesë së sallës së arsimtarëve, ndërsa në në objektin e Lagjes Dushkaja është bërë ngjyrosja e mureve të brendshme, montimi i 18 dyerve dhe rregullimi i një pjesë të kulmit

Në ShFMU "Qamil Ilazi" në Kaçanik të Vjetër – paralelja në Fushë të Pajtimi, është ndërtuar aneksi i dedikuar per toalete dhe janë rregulluar shkallët për katin e dytë.

Në ShFMU "7 Shtatori" në Begracë është bërë renovimi i toaleteve, montimi i 3 dyerve të reja dhe rregullimi i sistemit të ngrohjes.

Në ShFMU "Jusuf Gërvalla" në Biçec është bërë ngjyrosja e mureve të brendshme, montimi i 11 dyerve dhe punimi i shkallëve për katin e II, ndërsa në paralelen e ndarë në Nikaj është bërë ngjyrosja e një pjese të murit të brendshëm dhe renovime tjera të imta.

Në ShFMU "Kadri Zeka" në Dubravë është bërë ngjyrosja e mureve të brendshme, montimi i 20 dyerve, ndërsa në shkolën e fshatit Vatë është rregulluar fusha sportive.

Në ShFMU "Idriz Seferi" - Paralelja e ndarë fizike në Gajre është ndërtuar aneksi i dedikuar per toalete dhe rregullimi i rrethojës.

Në Shkollën "Dituria" në Ivajë është bërë shtruarja e oborrit të shkollës me kubëza betoni, ndërsa në Paralelen e ndarë në Strazhë eshtë rregulluar fusha sportive.

Në ShFMU "Nazmi Osmani" në Elezaj është bërë ngjyrosja e mureve të brendshme, ndërrimi i 14 dyerve dhe rregullimi i dyshemese me linoleum, ndërsa në paralelen e Bajnicës janë renovuar toaletet, janë ndërruar 13 dyer dhe është bërë ngjyrosja e mureve të brendshme.

Në ShMP "Feriz Guri dhe Vëllezërit Çaka" në Kaçanik ka filluar me vonesë ndërtimi i rrethojës së oborrit, ndërsa në Gjimnazin "Skënderbeu" në Kaçanik, në oborrin e shkollës është bërë veshja e shkallëve të jashtme me pllaka.

Në ndërkohë disa nga shkollat janë pajisur me inventar shkollor si banka, karrika për nxënës, karrika për mësimdhënës (për sallë të arsimtarëve), sirtarë, vitrina, tavolina për mësimdhënës në klasa, kompjuter, perde, tepihë për klasa parafillore dhe tabela shkollore, ndërkaq në Gjimnazin "Skënderbeu" është rregulluar, Kabineti i biologjisë me mjete e pajisje tjera. Po ashtu, në Shkollën profesionale janë pajisur me materiale punëtoritë shkollore: ai i elektrikës, nxehjes, metal punues dhe ujësjellësit, e në çerdhën e fëmijëve është kompletuar kuzhina si dhe janë vendosur televizorë në klasa e pajisje tjera.

Në Shtëpinë e Kulturës "Xheladin Kurtaj" janë rinovuar nyjat sanitare , një pjesë e hollit dhe pjesa te hyrja kryesore. Gjatë vitit 2021 kanë përfunduar punimet në Palestrën sportive dhe është punuar sipas dinamikës së paraparë ne rregullimin e tribinave të Stadiumit "Besnik Begunca".

## Aktivitetet kulturore, sportive, rinore dhe përkrahja e tyre

Përhapja e pandemisë COVID 19 ka kufizuar aktivitet pasi ruajtja e shëndetit ishte prioritet, ndërkohë disa nga aktivitetet, megjithatë janë shënuar. Rinia shkollore ka mbajtur të gjitha garat sportive të organizuara nga Shoqata e Pedagogëve të Edukates Fizike dhe të përkrahura edhe nga DAK. Gjithashtu janë organizuar Olimpiada e Matematikës dhe e Fizikës. Të gjitha klubet sportive i kanë realizuar garat sipas planifikimit por përherë duke respektuar këshillat nga MSH dhe IKSHP-ja. Organizatat rinore i kanë realizuar të gjitha aktivitetet e planifikuara. Janë organizuar ditët e diasporës me aktivitete kulturore dhe sportive.

Për aktivitetet e tyre dhe projektet konkrete, janë përkrahur me subvencione të gjitha klubet sportive, Shoqëritë Kulturore Artistike dhe Organizatat rinore.

## Drejtoria e Shërbimeve Publike dhe Emergjencës

KAÇANIKU

Raporti përmbledhës i punës njëvjeçare në kuadër të Drejtorisë se Shërbimeve Publike dhe Emergjencave ka për qëllim raportimin për kryetarin e komunës, komitetit për Shërbime Publike si dhe informimin e opinionit publik për punën e DSHPE-së për periudhën janar-dhjetor 2021.

Është raport përmbledhës dhe njëherit paraqet punët e përgjithshme të kësaj drejtorie të cilat në një formë apo tjetër kanë ndikuar drejtpërdrejtë në jetën e qytetarit.

Të gjitha aktivitet e poshtëshënuara janë realizuar në bashkëpunim të plotë me kryetarin e komunës dhe drejtoritë tjera të ekzekutivit komunal.

### I. INFRASTRUKTURA RRUGORE

Drejtoria e Emergjencve dhe Shërbimeve Publike në kuadër të përgjegjësive dhe aktiviteteve të saja edhe gjatë vitit 2021 është përkushtuar në realizimin dhe menaxhimin projekteve kapitale brenda listës së projekt buxhetit për investime kapitale për vitin 2021, i miratuar nga kuvendi komunal dhe projekteve kapitale të përfituara në bashkëfinancim më ministritë e ndryshme. Në bashkëpunim me zyrën e kryetarit dhe të drejtorive tjera është angazhuar për implementimin dhe menaxhimin e projekteve të infrastrukturës rrugore të cilat janë parqitur si vijon:

- **Asfaltime dhe ndërtime të rrugëve lokale nga buxheti i komunës**

Gjatë kësaj periudhe, nga lista e investimeve kapitale me buxhetin e komunës janë realizuar gjithësej **3** projekte rrugësh të asfaltuar, ku gjatësia e rrugëve të ndërtuara arrin **=3716m**

| Nr. | Emërtimi | Gjatësia/m |
|---|---|---|
| 1 | Asfaltimi i rrugës në lagjet Dalloshi, Murseli dhe Cena | 1245m |
| 2 | Asfaltim i rrugës "Ramadan Xhokli"-Koxhaj | 1266m |
| 3 | Rehabilitimi i rrugës "Qamil Ilazi' dhe "Sali Bajra"-Kaçanik | 1205m |
| | **Total** | **3716m** |

- **Implementimi i projekteve nga Grandet e Performancës.**

Në kuadër të Memorandumeve të Mirëkuptimit me MAPL-në, me qëllim të implementimit të projekteve nga Grand i Performancës kemi përfituar **145,266.54€**, kemi implementuar (2) dy projekte në rregullimin e infrastrukturës rrugore. Më këtë shumë të mjeteve janë bashkëfinancuar projektet "**Rehabilitimi i rrugës"Qamil Ilazi" dhe "Sali Bajra"** dhe "**Ndërtimi i trotuarit Bob-Doganaj**"

| Nr. | Emertimi | |
|---|---|---|
| 1. | **Rehabilitimi i rrugës "Qamil Ilazi" dhe "Sali Bajra"** | |
| 2 | **Ndërtimi i trotuarit Bob-Doganaj-faza III** | |

- **Implementimi i projekteve nga MZHR-ja.**

Në kuadër të Memorandumeve të Mirëkuptimit me MZHR-në-në, kemi përfituar Grand në vlerë 50,000.00€, mjete të cilat janë përdorur për bashkëfinancim të projektit :
**Asfaltim i rrugës "Ramadan Xhokli"-Koxhaj.**

| Nr. | Emertimi | Gjatësia |
|---|---|---|
| 1. | Asfaltim i rrugës "Ramadan Xhokli"-Koxhaj | 1266m |

## II. UJËSJELLËSI

- **Rregullimi i sistemit aktual të ujësjellësit dhe ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellësit**

Projekti "**Ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësit**"-.

| Nr. | Emertimi | Gjatësia/m |
|---|---|---|
| 1. | Shtimi i kapacitetit të ujit në Dubravë-Doganaj-Elezaj (2 burime dhe 1700m Φ 110 rrjet primar) | 1700m |
| 2 | Aktivizimi i rezervuarit 1000m$^3$ dhe vendosja e 800m rrjet të ri Φ 315 nga rezervuari deri te Halla e Sportit-Kaçanik. | 800m |
| 3 | Shtim i kapacitetit të ujit në Glloboqicë (kaptimi i 8 burimeve dhe 2300m rrjet primar | 2300m |
| 4 | Shtim i kapacitetit te ujit në qytet (aktivizimi i pompës nga pusi te ish fabrika e Gelqeres) | 350m |
| 5 | Hapja e kanalit dhe vendosje e gypit Φ 63 për lagjen Smokaj-Begracë (1251m rrjet /rezervuar-lagje Smokaj) | 1251m |
| 6 | Ndërrimi i gypave të rrjetit të ujësjellësit nga materiali i asbestbetonit me gypa polietileni Φ200 në rrugën "Qamil Ilazi" dhe "Sali Bajra"-Kaçanik | 660m |
| 7 | Vendosja gypit Φ 63 polietilen për kyqje shtëpiake në rrugën "Qamil Ilazi" dhe "Sali Bajra"-Kaçanik | 875m |
| 8 | Punimi i murit rrethues te peshorja e ujit në Sepetin-Dubravë h=1.80m | 60m |
| | **Totali** | **7936m** |

- **Furnizim me gypa të ujësjellësit**

| Nr. | Emertimi | Gjatësia/m |
|---|---|---|
| 1. | Furnizimi me gypa të ujësjellësit Φ 75 për nevoja të ujësjellësit në fshatin Strazhë | 4500m |
| 2 | Furnizimi me gypa të ujësjellësit Φ 50 për lagjen Fazliu në fshatin Duraj | 1200m |
| 3 | Furnizimi me gypa të ujësjellësit Φ 63 për nevoja të rrjeteve të ujësjellësit | 1228m |
| 4 | Furnizimi me gypa të ujësjellësit Φ 75 për nevoja të rrjeteve të ujësjellësit | 600m |
| 5 | Furnizimi me gypa të ujësjellësit Φ 110 për nevoja të rrjeteve të ujësjellësit | 2000m |
| | **Totali** | **9528m** |

## III. KANALIZIMET

Në kuadër të kodit buxhetor **"Ndërtimi i kanalizimeve fekale dhe atmosferike"** janë realizuar këto projekte:

| Nr | Emërtimi i projektit /Lokacioni i punishtes | Gjatësia | profili i gypit |
|---|---|---|---|
| 1 | Kanalizimit fekal në lagjen Bajrami-Stagovë | 350m | Ø315 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 2 | Kanalizimit fekal në lagjen Kek-Kaçanik i Vjetër | 820m | Ø250 |
| 3 | Kanalizimit fekal në lagjen Ismajli dhe Terziu-Elezaj | 825m | Ø250 |
| 4 | Kanalizimit fekal në rr."Qamil Ilazi"dhe "Sali Bajra" | 220m | Ø500 |
| 5 | Kanalizimit fekal në lagjen Deda-Doganaj | 60m | Ø200 |
| 6 | Kanalizim fekal në fshatin Duraj | 120m | Ø200 |
| 7 | Kanalizim fekal në Ivaje-lagjja Zmak | 230m | Ø200 |
| 8 | Kanalizim fekal në lagjen Kamishi-Dubravë | 350m | Ø250 |
| 9 | Kanalizim fekal në Lagje te Re-Kaçanik | 35m | Ø315 |
| 10 | Kanalizim fekal te shkolla"Idriz Seferi"-Gajre | 260m | Ø200 |
| 11 | Kanalizim fekal në fshatin Bajnicë | 250m | Ø200 |
| 12 | Kanalizim fekal në fshatin Gërlicë-Prushaj | 480m | Ø200 |
| | **TOTAL** | **4000m** | |

- **Ndërtimi i rrjetit të ri të kanalizimeve**
- **Ujërat sipërfaqësore**

Gjatë këtij viti 2021, kemi investuar në ndërtimin e disa rrjeteve të ujrave atmosferike. Kemi ndërtuar rrjetin e kanalizimit te ujrave atmosferike dhe ndërtim të shtretërve të cilat janë paraqitur në tabelën vijuese:

| Nr. | Emërtimi | Gjatësia |
|---|---|---|
| 1 | Kanalizimit atmosferik në lagjen Bajrami-Stagovë | 350m |
| 2 | Kanalizimit atmosferik në rr."Qamil Ilazi"dhe "Sali Bajra" | 758m |

| | | |
|---|---|---|
| 3 | Kanalizimit atmosferik në rrugën"Ramadan Xhokli"-Koxhaj | 1275m |
| 4 | Kanalizim atmosferik në fshatin Duraj | 120m |
| 5 | Kanalizim atmosferik në fshatin Bajnicë | 50m |
| | **Totali** | **2553m** |
| | | |
| | **Pastrim i shtretërve të përrockave dhe lumenjëve** | |
| 1 | Pastrimi i shtratit të përrockave (lagjja Hysa dhe Jaha)-Stagovë | 250m |
| 2 | Pastrimi i shtratit të përrockes në lagjen Kek-K.Vjeter | 150m |
| 3 | Pastrimi i shtratit të lumit Nerodime-Kaçanik | 650m |
| 4 | Pastrimi i përrockës së Rakocit | 198m |
| | **Totali** | 1248m |

## IV. MENAXHIMI I MBETURINAVE

Edhe gjatë këtij viti jemi fokusuar ne implementimin dhe realizimin e objektivave te Planit Komunal për Menaxhimin e Mbeturinave 2016-2021.

Kemi vazhduar në implementimin e projektin"**Furnizimi me shporta për mbeturina 120l**". Ka vazhduar shpërndarja e shportave klienteve të rinjë.

Kemi lidhur marrëveshje me operatorin privat NTSH "Krasniqi"-Kaçanik i Vjeter për grumbullim te mbeturinave në Zonën e III-të.

Jemi perfitues në garën Grandi i Performaces-Mjedisi i Paster-Raundi i III-te dhe jemi shpërblyer me shumën **101,272.00€**

Në projektin "Gara për Mjedis të Pastër" nga GIZ-i kemi përfituar edhe **21 kontenjerë 1.1m³** si pjesë e mjeteve nga Grandi i Performancës –Mjedisi i Pastër.

Mbulueshmëria e teritorit të kaçanikut me shërbim të grumbulliit të mbeturinave është:**77.15%.**

## V. KOMUNIKACIONI RRUGOR

### ➢ Shenjëzimi Horizontal dhe Vertikal

Gjatë vitit 2021 përmes kompanisë për rregullimin dhe mirëmbajtjen e sinjalizimit horizontal dhe vertikal kemi realizuar projekte të kësaj fushe në shenjëzim horizontal dhe vertikal në rrugët lokale:

**Sinjalizimin vertikal** janë sinjalizuar këto rrugë:

- rr."Ismail Raka",
- rr."Avdurrahim Shehu",
- rr."Agim Bajrami",
- rr."Vëllezërit Çaka",
- rr."10 Gushti",
- rr."Liria",
- rr."Feriz Guri",
- rr."Sadik Guri",
- rr."Adem Jashari" dhe
- rr."Ekrem Gudaqi".

**Sinjalizimin horizontal** janë sinjalizuar këto rrugë:

- rr. Ismail Raka ( dy degëzimet - te banesa P+8 dhe ka ETC),
- rr. Avdurrahim Shehu,
- rr."Vëllezërit Çaka",
- rr."Izahir Troni" deri te udhëkryqi me rr."Mynyr Thaqi",
- rr."Baki Dullovi",
- rr."Feriz Guri" (prej Magjistrales deri te Pompa) dhe
- rr."Epopeja e UÇK-së".

| Nr. | Emërtimi | Sasia |
|---|---|---|
| | **Sinjalizim vertikal** | |

| | | |
|---|---|---|
| 1. | Shenja të rrezikut | 10 copë |
| 2 | Shenja të urdhëresave të prera | 54 copë |
| 3 | Shenja të lajmërimit, | 51 copë |
| 4 | Tabelë plotësuese | 2 copë |
| 5 | Pasqyre | 9 copë |
| 6 | Shtylla antipark | 4 copë |
| 7 | Shenja të emërtimit të rrugëve | 50 copë |
| | **Sinjalizim horizontal-material njëkomponent** | |
| 1 | Vija e plotë | 489m |
| 2 | Vija e ndërprerë | 1799m |
| 3 | Vendkalim këmbësor | $132.50m^2$ |
| 4 | Vija e ndaljes dhe vija stop | $5m^2$ |
| 5 | Shenjëzim i vendparkingjeve | $35.50m^2$ |
| 6 | Shenja për persona me aftësi të kufizuar | 3 copë |
| 7 | Mbishkrime QKMF | 8 copë |
| | **Sinjalizim horizontal-material dykomponent** | |
| 1 | Vija e plotë | 1142m |
| 2 | Vija e ndërprerë | 3315m |
| 3 | Shenjëzim i vendparkingjeve | $85m^2$ |
| 4 | Policë të shtrirë | 78.50m |

- **Transportit publik**

Transporti publik i udhëtarëve në komunën tonë ka funksionuar mirë. Jemi fokusuar në zbatimin e rregullores komunale për tansportin publik. Janë paisur të gjithë operatorët me autobus, kombi-bus dhe auto taksi me leje pune dhe janë vërtetuar rendet e udhëtimit për linjat urbano-periferike. Aktualisht funksionon transporti publik i udhëtarëve në të gjitha vijat të cilat janë shpallur nga DSHPE-ja (pos në relacionin Kaçanik -Kotlinë, ku nuk kemi operator të interesuar).

Janë subvencionuar të gjithë operatorët e autobusëve dhe kombibusëve dhe stacioni i autobusave, si mbështetje gjatë masave nga Covid-19.

## VI. HAPËSIRAT PUBLIKE

### ➢ Gjelbërimi dhe Parqet

Në kuadër të projektit "**Rregullimi dhe ndërtimi i parqeve publike**" është bërë rregullimi i ulseve në parkun e qytetit dhe përgjatë bulevardit "Ismajl Raka" si dhe janë vendosur shporta për mbeturina pranë ulseve.

| Nr. | Emërtimi | Copë |
| --- | --- | --- |
| 1. | Punimi dhe vendosja e ulseve në bulevardin "Ismajl Raka"-Kaçanik | 28 copë |
| 2 | Punimi dhe vendosja e shportave në bulevardin "Ismajl Raka"-Kaçanik | 36 copë |
| 3 | Punimi i ulseve nga druri në tribunat e parkut të qytetit | $50m^2$ |

Kemi realizuar një projekt në vlerë **9,500.00€** për pastrimin e shtratit të lumit Nerodime, kositjen e hapësirave të gjelberuara dhe mirëmbajtjen e drunjëve dekorativ.

### ➢ Pastrimi dhe mirëmbajtja e varrezave

Gjatë vitit 2021 është bërë pastrimi dhe kujdes i vazhdueshëm i varrezave të dëshmorëve, posaqërisht pra çdo date të shënuar për përkujtime apo festa shtetërore dhe komunale. Është mirëmbajtur hapësira e gjelbëruar, lulet dhe drunjët dekorativ.

Poshtu kemi nënshkruar marrëveshje me KRM "Pastërtia" për mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbëruara (kositje e barit, ujitje dhe pastrim të hapësirave publike).

## VII. Trotuare

Gjatë vitit 2021 në kuadër të investimeve kapitale janë ndërtuar edhe 11 projekte të trotuarëve për këmbësorë ne gjatësi= **9230m .**

| Nr. | Emërtimi i projektit | Gjatësia/m |
|---|---|---|
| 1 | Ndërtimi i trotuareve në rr. Qamil Ilazi dhe "Sali Bajra"Kaçanik | 2010m |
| 2 | Ndërtimi i trotuarit në rr. "Avdyl Dura" dhe rr."Hetem Hasaj" | 1740m |
| 3 | Ndërtimi i trotuarit në rr. Bob-Doganaj-faza III | 1800m |
| 4 | Ndërtimi i trotuarit në rr. "Ramadan Xhokli"-Koxhaj | 1250m |
| 5 | Ndërtimi i trotuarit në rrugën "Malsia"-Rekë | 560m |
| 6 | Ndërtimi i trotuarit në rrugën "Kongresi i Manastirit"-Soponicë | 150m |
| 7 | Ndërtimi i trotuarit në rrugën "Beteja e 25 Majit"-lagjja Provoliu | 260m |

| | | |
|---|---|---|
| 8 | Ndërtimi i trotuarit në rrugën "Hamëz Jashari"-segmenti te Silkapori | 753m |
| 9 | Ndërtimi i trotuarit në rrugën "Komandant Bardhi"-K.Vjetër-Begracë | 491.50m |
| 10 | Ndërtimi i trotuarit në rrugën "Skenderbeu"-Kaçanik | 93.50m |
| 11 | Ndërtimi i trotuarit në rrugën "Ahmet Kaçiku" Elezaj- Duraj | 122m |
| | **TOTALI** | **9230m** |

**VIII . Parkingjet**

Gjatë vitit 2021, kujdes i veçant i është kushtuar krijimit të hapësirave të reja per parkingje publike. Jane ekzekutuar projekte të kësaj fushe në keto lokacione:

| **Nr.** | **Emërtimi** | **Nr. i parkingjeve** |
|---|---|---|

| | | |
|---|---|---|
| 1 | Rindërtimi i parkingjeve në bulevardin e qytetit | 142 |
| 2 | Ndërtimi i parkingjeve përballë QKMF-së | 21 |
| 3 | Ndërtimi i parkingjeve te banesat afer stacionit te autobusëve | 11 |
| 4 | Ndërtim i parkingjeve në rrugën"Skenderbeu"-Kaçanik | 22 |
| 5 | Ndërtim i parkingjeve në oborrin e shkollës në Kovaçec | 15 |
| 6 | Ndërtimi i vendparkingjeve te banesa P+8 | 8 |
| | **Totali** | **219 parkingje** |

- **Ndërtim i stazave për këmbësor**

Është realizuar ndërtimi i stazës së re metalike për këmbësor rr. "Ismajl Raka"-Kaçanik pas Shtëpisë së Kulturës në gjatësi 62m.

| Nr | Emërtimi i projektit | Gjatësia |
|---|---|---|
| 1 | Ndërtimi i stazës metalike për këmbësor pas Shtëpisë së Kulturës | 62m |
| | | |
| | **Total** | **62m** |

KAÇANIKU

## IX. NDRIÇIMI PUBLIK

Projekti kapital "**Rregullimi i ndriçimt publik**" është ekzekutuar në këto lokacione

| Nr | Emërtimi i projektit /Lokacioni i punishtes | Gjatesia(m) | Nr.Trupave |
|---|---|---|---|
| 1 | Ndriçimi publik në rrugën kryesore - fsh. Begracë | 3000m | 102 |
| 2 | Ndriçimi publik në rrugën "Baki Dullovi" fsh. Biçec | 1540m | 46 |
| 3 | Ndriçimi publik në rrugët "Feriz Guri" dhe "Qemal Guri" fsh. Nikaj | 1544m | 46 |
| 4 | Ndriçimi publik në rrugët "Viktoria", një pjesë e rr."Skënderbeu", një krah i rr."Nexhmush Elezi" Kaçanik | 320m | 10 |
| 5 | Ndriçimi publik në rrugët "Elham Hasani","Muhamet Lama" fsh.Semajë | 900m | 35 |
| 6 | Ndriçimi publik në rr. "Brahim Muça"deri te Xhamia dhe rr."Mynyr Thaçi" faza e II-të, | 680m | 19 |
| 7 | Ndriçimi publik në rrugën " Komandant Bardhi" fsh.Kaçanik i vjetër-faza II-të | 552m | 13 |
| 8 | Ndriçimi publik në rrugën "Brigada 162 Agim Bajrami"-fsh .Gajre | 480m | 22 |
| 9 | Ndriçimi publik në rrugën "Arif Ceka-Kapedani dhe degëzimi ka | 1150m | 36 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | shkolla", "Fshati i Vjeter","Qani Luma", fsh .Glloboçicë | | |
| 10 | Ndriçimi publik në rr. Avdyl Dura" dhe "Hetem Hasaj-Duraj-Gabrricë | 1928m | 57 |
| 11 | Ndriçimi publik në rr."Ramadan Xhokli"-Koxhaj | 1438m | 43 |
| 12 | Ndriçimi publik në rr."Hasan Prishtina"-Kaçanik | 200m | 5 |
| 13 | Ndriçimi publik në rr."Shaban Elezi"-Sllatinë | 1000m | 22 |
| 14 | Ndriçimi publik në degëzimin e rr."Kjani Bela" -Kaçanik | 120m | 3 |
| 15 | Ndriçimi publik në rr."Sylejman Reka"-Kaçanik | 250m | 6 |
| | Totali | **14202m** | 443 copa |

- **Mirëmbajtje e rrjeteve ekzistuese**

Poashtu gjatë këtij viti është nënshkruar kontrata për mirmbajtjen e ndriçimit publik për periudhën (3) trevjeçare, ku jemi angazhuar në mirembajtjen e ndriçimit aktual dhe zgjërimit në disa pjesë të lagjeve urbane të qytetit.

Edhe gjatë këtij mandati, kemi dhënë pëlqime për rregullimin dhe shtrirjen e rrjetit të ndriçimit publik në lagjen dhe fshatrat ku komuniteti është shprehur i gatshëm të vetëfinancoi projektin.

**Kemi dhënë pëlqime për rregullim të ndriçimit publik në:**

- Lagjja Vishaj-Dubravë
- Lagjja Memaj-Dubravë
- Lagjja Horuni-Biqec
- Lagjja Sallahu –Biqec
- Lagjja Elezi-Sllatinë
- Lagjja Neziraj dhe Dullovi-Vataj.

## X. MIRËMBAJTJE E RRUGËVE LOKALE

- Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale 2021

Gjatë vitit 2021, DSHPE-ja është angazhuar në vazhdimësi në realizimin e kontratës për mirëmbajtjen e vazhdueshme të rrugëve lokale gjatë sezonës verore dhe dimërore. Krahas mirëmbajtjes rutinore gjatë kësaj kohe si (largimi i dheut nga rrëshqitjet, mbushja e gropave me shtresë asfalti, pastrimi i kanaleve të ujrave atmosferike, ndërtim i mureve mbrojtëse, largimi i borës, hudhja e kripës industriale, etj), janë bërë edhe rehabilitime të dukshme të rrugëve me shtresë zhavori dhe shtresë të re asfalti.

**Aktivitetet e realizuara me kontratën Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve lokale 2021**

- Pastrimi i rrugëve nga bora dhe hedhja e kripes
- Pastrimi dhe zgjerimi i rrugës "Komandat Bardhi" në fsh. Begracë, me gjatësi L=1240 m'
- Rehabilitimi i gropave me zhavor në rrugën "Idris Seferi"
- Rehabilitimi i gropave me zhavor në rrugën "Rexhep Teneqja"
- Nivelizimi dhe shtrimi me zhavor në oborrin tek dhoma e pritjes në lagjen Vishaj në fsh. Dubravë
- Zgjerimi dhe shtrimi me zhavor i rrugës "Epopeja e UÇK-së" në fsh. Kaçanik i Vjetër
- Intervenim me zhavor me rastin e daljes nga shtrati i lumit Lepencë, më datë 11.01.2021
- Nivelizimi dhe shtrimi me zhavor i dy krahëve të rrugës "Epopeja e UÇK-së" në fsh. Kaçanik i Vjetër, me gjatësi totale L=247 m'
- Shtrimi me zhavor i rrugës në lagjen e "Kotlinëve" në fsh. Kaçanik i Vjetër
- Nivelizimi dhe shtrimi me zhavor i rrugës "Kroji" në lagjen Memaj të fsh. Dubravë me gjatësi L=97 m'
- Zgjerimi dhe shtrimi me zhavor i rrugës "Lumnas" në Soponicë, me gjatësi L=547 m'
- Nivelizimi dhe shtrimi me zhavor i rrugës "Fatime Asanraka" në Koxhaj me gjatësi L=191 m'
- Pastrimi i rrugës në fsh. Gajre nga shembjet e dheut me datë 18.02.2021 dhe 01.04.2021
- Shtrimi me zhavor i krahut të rrugës "Izahir Troni", tek lagjja "Muça" në fsh. Kovaçec, me gjatësi L=194 m'
- Shtrimi me zhavor i krahut të rrugës "Izahir Troni", tek lagjja "Trupi" në fsh. Kovaçec, me gjatësi L=54 m'

- Nivelizimi dhe shtrimi me zhavor i krahut të rrugës "Ahmet Kaçiku", në fsh. Soponicë, përballë "Shkëndia Petrol", me gjatësi L=190 m'
- Zgjerimi dhe shtrimi me zhavor i krahut të rrugës "Ahmet Kaçiku", në fsh. Elezaj, përballë restorant "Natyra", me gjatësi L=160 m'
- Nivelizimi dhe shtrimi me zhavor i krahut të rrugës "Liria", në fsh. Gërlicë e Epërme, me gjatësi L=55 m'
- Rrafshimi i deponisë në rrugën "Idriz Seferi" në Kaçanik
- Rehabilitimi me zhavorr në rrugën "Te Dëshmorët" në fsh. Llanishtë
- Pastrimi me autobot i rrugëve të qytetit me datë 12.05.2021
- Rrënimi i WC-ve të vjetra tek shkolla fillore në fsh. Gajre
- Rrënimi i murit në rrugën "Selim Shehu"
- Mbulimi me dhe, i gropës septike tek objekti i shkollës fillore në fsh. Koxhaj
- Rregullimi me zhavor i lëshesës atmosferike afër rrugës "Ilirët" në fsh. Dubravë
- Rehabilitimi me kubëza betoni në kyçjet e lokaleve përreth magjistrales Kaçanik-Ferizaj, pas punimit të ujësjellësit përskaj kësaj rruge
- Ndërtimi i murit mbrojtës në rrugën "Besnik Begunca", me gjatësi L=27 m'
- Hapja e gropave dhe betonimi i tyre, për vendosjen e shtyllave elektrike dhe transformatorit, në rrugën "Kemal Kolshi" në fsh. Doganaj
- Hapja e kanalit të ujësjellësit në fsh. Gabrricë me gjatësi L=90 m'
- Demolimi i rrethojave të vjetra, pastrimi i terenit dhe hapja e themeleve për ndërtimin e rrethojave të reja, tek varrezat e vjetra të qytetit
- Hapja e kanalit për rregullimin e kaptazhës në parcelën 1050-2 në ZK Sllatinë
- Pastrimi me autobot i rrugëve të qytetit me datë 31.07.2021
- Zgjerimi dhe shtrimi me zhavor i rrugës "Shaqir Kuka" në fsh. Bob
- Asfaltimi i gropave në rrugën "Sali Bajra"
- Prerja e asfaltit dhe vendosja e lëshesës atmosferike në rrugën "Beteja e 25 majit" në fsh. Dubravë
- Mbulimi i gropave me zhavor në rrugën "Idriz Seferi" me datë 04.08.2021
- Hapja e gropave dhe betonimi i tyre, për vendosjen e shtyllave elektrike të tensionit të lartë në rrugën "Adem Jashari" dhe "Ekrem Gudaqi" në fsh. Stagovë
- Rehabilitimi i bankinës me zhavorr në rrugën "Hetem Hasaj" në fsh. Gabrricë
- Ndërtimi i murit të rrethojave tek Sh.f. në fsh. Kovaçec
- Hapja e rrugës në fsh. Stagovë, për vendosjen e shtyllave elektrike me gjatësi L=437 m'
- Ndërtimi i kanalizimit në rrugën "Rexhep Luzha" në fsh. Begracë, me gjatësi L=67 m'
- Hapja e gropave dhe betonimi i tyre, për vendosjen e shtyllave elektrike në rrugën "Hetem Hasaj" në fsh. Duraj
- Ndërtimi i murit mbrojtës në rrugën "Shkëlzen Haradinaj" në fsh. Runjevë me gjatësi L=20 m'
- Hapja e kanalit, vendosja e lëshesave ekzistuese dhe mbulimi me zhavorr në përroin e fsh. Rekë
- Pastrimi i rrugës "Abush dhe Ilaz Loku" në fsh. Kotlinë, nga shembjet e dheut
- Nivelizimi dhe shtrimi me zhavor në fshatin Vataj - Dubravë, tek oborri i objektit të përbashkët të lagjes Imishtë
- Hapja e gropave dhe betonimi i tyre, për vendosjen e shtyllave elektrike të tensionit të ulët dhe dy transformatorëve në rrugët e fsh. Stagovë

## XI. Sektori i Emergjencave

**Aktivitetet e Sektorit të emergjencave gjatë vitit janar – dhjetor 2021**

Duke u bazuar në përgjegjësitë dhe ligjet në fuqi, DSHPE-së - Sektori i emergjencave ka ndërmarrë masa të nevojshme për parandalimin e fatkeqësive të ndryshme, në bashkëpunim me subjektet relevantë duke bërë koordinimin e plotë, duke u bazuar nga lloji i fatkeqësive dhe përmasat e shkallës emergjente.

Në kuadër të tërë kësaj, do ta paraqesim raportin sipas aktiviteteve të zhvilluara për tërë vitin kalendarik 2021.

Ky vit ka filluar me dëme të shkaktuara nga reshje e shiut që ndodhën më **11.01.2021** duke përmbytur objektin **"SANKOS" Sh.P.K** (Fabrika e konfeksionit të tekstilit dhe mjeteve mbrojtëse në punë), për fat të keq ky objekt është përmbytur edhe gjatë vërshimeve të më hershme që ndodhën më **31.11.2017** dhe **01.12.2017**

Me këtë rast DSHPE - Sektori i emergjencave, ka marrë masat e nevojshme për parandalimin e vërshimeve duke intervenuar me 2 kamionë zhavorr, njëkohësisht ka bërë evakuimin e 3 punëtorëve të kësaj kompanie që kanë të ngujuar në ketë objekt.

Nga Dëmet e shkaktuar nga vërshimet në dy ndërtesat e banimit kolektiv që ndodhen në rrugën "Vëllezërit Çaka" është larguar uji nga bodrumet me anë të pompave nga NJPZSH-ja

Komisioni i përkohshëm për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga reshjet e fundit të shiut ka bërë raportin e vlerësimit të dëmeve dhe konstatoi se dëmet janë **61.455,10€**

- **Me 09. 02. 2021** është bërë i informimi lidhur me vërshimet (janar 2021) dhe pyetësorin e ofruar nga z. Shaqir Shaqiri i Qendrës së Situatave në Prishtinë.

- **Me 10.06.2021** me propozim të drejtorit të DSHPE-së dhe me Vendim të Kryetari të Komunës është formuar **Shtabi Emergjent Komunal** për kërkimin e të zhdukurit Muhabi Islami i lindur në fshatin Begracë.

Kërkimi ka filluar me **dt.10.06.2021** në ora **09:00**, vendtakimi ka qenë afër shtëpisë së të zhdukurit në fsh. Begracë ku është vendosur Postkomanda e Incidentit në përbërje: zyrtari i komunës për emergjencë, Komandanti i zjarrfikësve, dy pjesëtarë të FSK-së dhe një pjesëtarë i Policisë së Kosovës

Në kërkim shpëtim të Muhabi Islamit nga fsh. Begracë kanë qenë të angazhuar:

- Zyrtar të Emergjencave të Komunës,
- Pjesëtarë të FSK-së,
- Policia,
- Familjarët e të zhdukurit,
- Vullnetarë dhe
- OJQ-të të ndryshme

Operacioni i kërkim shpëtimit i organizuar nga shtabi komunal i Kaçanikut ka zgjatur nga data **10.06.2021** deri më **17.06.2021** duke filluar nga ora **09:00** deri ora **17:00**, ku kanë qenë të përfshirë të gjithë akterët e lartpërmendur.

Gjatë ditëve sa ka zgjatur kërkim shpëtimi, **për furnizim me ushqim të vullnetarëve dhe pjesëtarëve të policisë të angazhuar në këtë aksion është kujdesur komuna.**

- **Me 22.06.2021** është mbajtur takim me Policinë e Kosovës ku temë diskutimi ishte bashkëpunimi me zyrtarët Komunal, ruajtja e pronës publike nga keqëbërësit dhe koordinimi i punëve.

- **Me 12.07.2021** është bërë **Njoftimi** i qytetarëve e Komunës së Kaçanikut për shkak të temperaturave të larta dhe rrezikut të ndezjes dhe përhapjes së zjarreve.

- **Me 20.09.2021** Ka filluar projekti "**Trajtimi i qenve endacak**" ku gjatë vitit 2021 janë trajtuar 74 qen endacak, projekti vazhdon deri në vitin 2023.

- **Me 30.09.2021** takim Regjional me AME, NATO, KFOR-in, Rishikim i Planit të Veprimit.

Ky vit, në vazhdimësi është karakterizuar me zjarre të hershme në mungesë të të reshurave e sidomos në periudhën: janar (11), shkurt (15 zjarre) dhe mars (22 zjarre), maj (30) të këtij vitit kemi pasur rritje të intervenimeve në shuarjen e zjarreve. Pas tremujorit të parë ne kemi marrë masat e duhura në ngritjen e gatishmërisë me, Njësisë Profesionale të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit, ku kemi mbajtur disa takime me Policinë e Kosovë, Inspektoratin e Zjarrfikjes së AME, zyrtarët e Pylltarisë, ku jemi dakorduar në marrjen e masave të duhura dhe në vazhdimësi kemi vazhduar bashkëpunimin në mes këtyre Institucioneve.

Në kuadër të kësaj kemi bërë një fushat vetëdijesuese për qytetarët përmes njoftimeve të përgjithshme si: komunikimit të drejtpërdrejt me qytetarë, këshillave të lagjeve dhe fshatrave, fletëlajmërimeve, mediave elektronike dhe rrjeteve sociale, me qëllim të njoftimit dhe të vetëdijesimit të qytetarëve në parandalimin e zjarreve fushore dhe pyjore.

Si rezultat i këtyre masave, gjatë sezonit të nxehtë verore në tre mujorin e tretë, përkundër temperaturave shumë të larta, ne kemi pasur rënie të dukshme të zjarreve malore dhe atyre fushore në muajit: korrik (17 zjarre), gusht (68 zjarre), ku këto zjarre janë intervenime të ndryshme dhe shumë pak fushore edhe më pak intervenime malore. Tërë kjo fal bashkëpunimit dhe koordinimit të mirë në mes të institucioneve, gjithashtu edhe vetëdijesimit dhe kujdesi i vetë qytetareve në parandalimin e zjarreve.

Njësinë Profesionale të Zjarrfikëseve dhe Shpëtimit e kemi furnizuar me dy (2) pompa për largimin e ujit nga bodrumet në rast të vërshimeve.Gjatë vitit 2021.

Njësia Profesionale e Zjarrëfikjes dhe Shpëtimit ka bërë 256 intervenime prej tyre:

| KATEGORIZIMI I ZJARREVE DHE INTERVENIMEVE SIPAS MUAJVE GJATË VITIT 2021 | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Lloji i intervenimit | Ja n. | Shk urt. | Ma rs | Pri ll | M aj | Qer sh | Ko rr. | Gus ht. | Sht at.. | Te t. | Në nt. | Dhj et. | Gjithësej |
| 1 | Zjarre | **5** | **15** | **22** | 17 | **29** | **16** | **17** | **66** | **40** | **11** | **10** | **8** | **256** |
| 2 | Intervenime teknike | **1** | | | | | **1** | **4** | **1** | **3** | **1** | | **1** | **12** |
| 3 | Shërbime | | | | | **1** | | | | | | | | **1** |
| 4 | Aksidente në komunikacion | | | | **1** | | | **2** | **1** | | **1** | | | **5** |
| 5 | Vërshime | **5** | | | | | | | | | | | | **5** |
| 6 | Alarme të rrejshme | | | | | | | | | | | | | |
| | **Gjithësej:** | **11** | **15** | **22** | **18** | **30** | **17** | **23** | **68** | **43** | **13** | **10** | **9** | **279** |

| | STATISTIKA -2021 | Gjatësia/copë |
|---|---|---|
| 1 | Ndërtim dhe asfaltim të rrugëve lokale | 3716m/3.7km |
| 2 | Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve fekale | 4000m |
| 3 | Ndërtimi i rrjeteve të kanalizimeve atmosferike | 2553m |
| 4 | Ndërtim i trotuareve për këmbësor | 9230m |
| 5 | Riparimi i rrugëve lokale të asfaltuara | 250m² |
| 6 | Rehabilitimi i rrugëve publike të pakategorizuara me shtresë zhavori | 3266m |
| 7 | Rregullimi dhe ndërtimi i parqeve publike<br>• Vendosje e ulseve në bulevard<br>• Vendosje e shportave në bulevard<br>• Rregullim i ulseve të drurit për tribuna në park të qytetit | 28 copë<br>6 copë<br>50m² |
| 8 | Sinjalizimi horizontal dhe vertikal<br>a. Shenja të rrezikut.........<br>b. Urdhëresa të prera.........<br>c. Shenja të lajmërimit.........<br>d. Tabelë plotësuese.........<br>e. Pasqyrë.........<br>f. Shtyllë antipark.........<br>g. Shenja emertim rruge.........<br>h. Vijë e plotë.........<br>i. Vijë e ndërprerë.........<br>j. Vendparkingje.........<br>k. Mbishkrime në rrugë (parkingje,QKMF, hendicap, etj).........<br>l. Policë të shtrirë......... | 10 copë<br>54 copë<br>51 copë<br>2 copë<br>9 copë<br>4 copë<br>5 copë<br>1631m<br>5114m |

| | | |
|---|---|---|
| | | 120m$^2$<br>11 copë<br>78.50m |
| 9 | Rregullim i ndriçimit publik | 14202m/ 443 trupa ndriçues |
| 10 | Ndërtim i stazave metalike për këmbësor | 62m |
| 11 | Furnizim me gyp ujësjellësi<br>a. Φ 110.........<br>b. Φ 75.........<br>c. Φ 63.........<br>d. Φ 50......... | 2000m<br>5100m<br>1228m<br>1200m |
| 12 | Pastrim i përrockave dhe lumenjëve | 5 aktivitete |
| 13 | Ndërtim i mureve mbajtëse dhe rrethuese | 4 projekte |
| 14 | Ndërtim i rrjeteve të ujësjellësit | 7 projekte |
| 15 | Pëlqime për rregullim të ndriçimit publik nga komunitetet | 6 pëlqime |
| 16 | Trajtim i qenëve endacak | 74 qenë |
| 17 | Ndërtim i vendparkingjeve për vetura | 219 vendparkingje |
| | | |

**Drejtoria e Ekonomisë, Financave dhe Zhvillimit Ekonomik**

**Drejtoria për Buxhet dhe Financa**

**Buxheti për vitin 2021**

KAÇANIKU

Përmes ndarjeve buxhetore për secilin sektor komunal është arritur që edhe të realizohen ne përpikmëri gjitha aktivitetet komunale si në aspektin e realizimit te projekteve kapitale, mallrave e shërbimeve, subvencioneve e transfereve, shpenzimeve komunale dhe pagave e meditjeve.

***Lidhur me ecurinë e shpenzimeve dhe të hyrave të gjithëmbarshme komunale, janë përgatitur tashmë dhe dërguar në MFPT Pasqyrat Vjetore Financiare per vitin e perfunduar më 31.12.2021 ku permes ketyre pasqyrave do te prezentohen gjitha shumat e shpenzuara neper secilen kategori ekonomike te shpenzimeve si dhe jane prezentuar shpalosje tjera detaje. Pasqyrat vjetore financiare te vitit 2021 do te jenë pikë ndaras e rendit te dites ne seancën e K.Komunal, andaj nuk e kemi prezentuara ne detaje permes ketij raporti, mirepo me poshtë po i'u bashkëngesim vetem tabelen e pergjithshme te buxhetit dhe shpenzimeve te realizuara gjatë vitit 2021:***

**Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për Komunën e Kaçanikut**
**Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021**

| | Shënime | 2021 Realizimi A €'000 | 2021 Buxheti final B €'000 | 2021 Buxheti fillestar C €'000 | 2021 Varianca D=B-A €'000 | 2020 Realizimi E €'000 | 2019 Realizimi F €'000 |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **HYRJA E PARASË SË GATSHME** | | | | | | | |
| Të hyrat tatimore | 8 | 374.79 | 324.71 | 324.71 | (50.09) | 263 | 293 |
| Të hyrat jo tatimore | 9 | 595.11 | 321.95 | 321.95 | (273.16) | 298 | 284 |
| Të hyrat e dedikuara | 10 | - | - | - | - | - | - |
| Grantet e përcaktuara të donatorëve | 11 | 21.17 | 23.73 | - | 2.56 | 11 | 6 |
| Tjera | 12 | 22.93 | 23.45 | - | 0.52 | | |
| Gjithsej Pranimet | | **1,014.00** | **693.83** | **646.66** | (320.17) | **572** | **583** |
| **DALJA E PARASË SË GATSHME** | | | | | | | |
| Paga dhe shtesa | 2 | 5,058.05 | 5,058.05 | 5,289.71 | - | 5,232.50 | 4,959.25 |
| Mallra dhe shërbime | 3 | 826.34 | 846.21 | 800.00 | 20 | 1,725.42 | 824.64 |
| Shpenzime komunale | 4 | 188.60 | 204.96 | 212.77 | 16 | 183.23 | 140.48 |
| Transfere dhe subvencione | 5 | 300.80 | 304.19 | 250.00 | 3 | 230.24 | 215.42 |
| Shpenzime kapitale | 6 | 2,279.83 | 2,672.98 | 2,230.13 | 393 | 1,654.08 | 1,971.73 |
| Rezerva | | - | - | - | - | - | |
| Tjerat | 7 | - | - | - | - | - | |
| Gjithsej pagesat | | **8,653.62** | **9,086.39** | **8,782.60** | 433 | **9,025.47** | **8,111.52** |

**Qendra Komunale për Regjistrimin e Bizneseve – Punët e realizuara 2021:**

**QKRB në Kaçanik gjatë periodës raportuese bëri këto punë:**

* Biznese të reja.......................................................................................116
* Ndryshime në Biznes.............................................................................68
* Shuraje të bizneseve...............................................................................13
* Çertifikata të reja.....................................................................................74
* Çertifikata Dublikatë.................................................................................15
* Informatat e Biznesit.................................................................................86
* Pagesa e taksës në Biznes......................................................................20
* Vertim qe nuk ka biznes te regjistruar.......................................................03
* Vërtetim për Biznes...................................................................................02
* Vertetim per tender....................................................................................24

Nga këto shifra që i prezentuam më lartë,jemi munduar që në pika të shkurtëra të prezentojmë punën e Qendrës komunale për regjistrimin e bizneseve **(QKRB)**, pa i përmendur këshillimet e përditshme rreth regjistrimit të bizneseve.

| hvillimi i bujqësisë, krijimi i vendeve të reja të punës , rritjen e të ardhurave shtesë në zonat rurale dhe ıbrojtja e pyjeve | |
|---|---|
| .ktivitete kryesore për ːalizimin e këtij prioriteti | Arritjet /progresi/ performanca kyçe gjatë periudhës janar –dhjetor, të vitit 2021 |

KAÇANIKU

<u>Drejtoria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Pylltarisë</u>

| | |
|---|---|
| Shqyrtimi i kërkesave të parashtruara nga palët dhe vendosja me kohë.<br><br>Mbështetja e fermerëve, në kompletimin e dokumentacionit, për aplikim në projektet e subvencionimit të fermerëve nga MBPZHR dhe projekteve me mjete nga buxheti komunës | Janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga qytetarët dhe për vendosjen kërkesave te tyre qytetarët janë informuar me kohë. jemi angazhuar në mbështetj e fermerëve gjatë pranimit të aplikacioneve. duke i ofruar ndihmë në plotësimir aplikacioneve me dokumentacione përcjellëse. gjatë aplikimit për subvencione projektet e ofruara nga MBPZHR dhe në realizimin e projekteve me mjete n buxheti komunës si dhe aktivitete tjera.<br><br>Gjithashtu gjatë kësaj periudhe fermerëve ju kemi ofruar mbështetje lidhur r marrjen e informacioneve për mos pagesat e subvencioneve nga MBPZHR. përm kontakteve me zyrtarët e Ministrisë së Bujqësisë. kemi informuar fermerët në lidl me pagesat e subvencionimit për fazën e dytë.<br>Si drejtori jemi angazhuar në mbështetjen e fermerëve përmes realizimit të projek të serrave.<br>Nga Projektet e ofruara të MBPZHR, për subvencionim të fermerëve ka aplikuar **318** fermerë, të cilët në tërsi janë subvencionuar, me disa prejashtir të vogla.<br><br>Nga projekti mbështetja e fermerëve me serra në sipërfaqe prej 50m² ka aplikuar **285 fermerë**, të cilët janë monitoruar me qëllim të përzgjedhjes fermerëve përfitues. Nga ky projekt kanë përfituar **177 fermerë**, serra r sipërfaqen e lartë cekur. Vlera e projektit **105,846.00 €,** participimi i fermerë 20% të vlerës së projektit (buxheti komunal **84,676.80€+21,169.20€** patrticipi i fermerëve).<br><br>Këtë vit kemi realizuar projektin për ndërtimin e kanaleve të hapura të ujitj në fshatin Doganaj dhe Nikaj, vlera e projektit **48,302.44 €.**<br><br>Me kërkesë të MBPZHR kemi hartuar raportin për fushatën e mbjelljeve pranverore dhe vjeshtore dhe korigjimin e raportit për dëmet nga të reshurat (breshëri) në kulturat bujqësore për periudl korrik- dhjetor 2020.Për këtë periudh fermerët që janë dëmtuar nga të reshurat e breshërit ja kompensuar në vlerë deri 30% të vlerës së demit. ndërsa për dëmet nga era dhe egërsirat, fermeri nuk i janë kopensuar dëmet.<br><br>Gjatë kësaj periudhe kemi monitoruar projektet që kemi mbështetur fermerët në tre vitet e fundit r serra, arrë, mekanizëm bujqësor.<br><br>Sa i përket kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore, janë shqyrtu 13 kërkesa, prej të cilave 11 janë të miratuara, 2 janë në proces për shqyrtim.<br><br>**Sipërfaqja e tokës bujqësore që është lejuar ndërrimi i destinimit është 28.4 m² apo shprehur në hektar** 2.80.409 ha. Nga vendosja e kërkesave për ndërri destinimi të tokës bujqësore në ndërtimore janë krijuar të hyra në shur prej **27,224.30€.**<br><br>Me kërkesë të palëve janë lëshuar 55 vërtetime lidhur me numrin e koshere |

| | |
|---|---|
| Mbështetja e fermerëve me këshilla profesionale | Fermerët kanë përfituar njohuri teorike dhe praktike me rastin e vizitave terren, gjithashtu fermerët janë mbështetur me këshilla individuale sip kërkesave së tyre, lidhur me vështirësit dhe problemet që i kanë përcjellı gjatë vitit. |

| | |
|---|---|
| Organizimi në mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale përmes shtimit të masave të veprimit në teren | - Rojet e pyllit dhe stafi i sektorit të pylltarisë, janë angazhuar për pengimin e dëmtimit të pyjeve nga prerësit dhe transportuesit ilegal të masës drusore.<br>- Për periudhën janar-dhjetor, janë konfiskuar **60.54m³** dru teknik, **161.56 m³** dru zjarri, në total 222.10 m³, masa drusore e trupave teknik prej 27m³, pjesë e komunës është shitur me ankand publik (1689.10€ ), ndërsa sasia e masës drusore (dru zjarri )gjendet në Autoparkun e SH.I.L-së është **161.56m³**, apo shprehur në metër hapësinor 231 **(mh)** prej kësaj mase drusore 50%, sipas kontratës i takojnë Shoqatës së Invalidëve të Luftës (SHIL) ndërsa pjesa prej 50% e masës drusore të konfiskuar i takojnë komunës..<br>- Janar- dhjetor janë ngritur 107 fletëparaqitje, prej tyre për kundërvajtje **99 dhe 8** për vepër penale.<br>- Vlen të theksohet se ketë vit nga dëmet pyjore, përmes përmbaruesit janë inkasuar 4,185.51 €. |

| | |
|---|---|
| Organizmi i takimeve me kryetarin e Komunës, Komandantin e Stacionit Policor, Kryetarin e Gjykatës, Prokurorinë si dhe takimeve të rregullta javore me stafin e sektorit të pylltarisë. | Për mbajtjen në kontroll e gjendjes së pyjeve, përmes koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta: Komunë, Polici dhe Shoqëria Civile, kemi organizuar takime të përbashkëta, me qëllim të pengimit të prerjeve ilegale të pyjeve. |
| Monitorimi dhe përcjellja e aktiviteteve të operatorëve ekonomik në shfrytëzimin e ngastrave pyjore të dhëna me tender. | - Shfrytëzimi i ngastrave të caktuara për prerje sipas planit menaxhimit, shitja me tenderë ngastrave, janë realizuar mjete në shumë prej **44,595.75 €**, nga shitja me pakicë (prerje sanitare) në pyjet publike janë realizuar **1,686.05€**. Nga mjetet e realizuara 30% e mjeteve kthehen në buxhet komunës 70% e mjeteve në APK-ës.<br><br>Janë pyllëzuar **10 ha** sipërfaqe me fidanë të pishës dhe bungut të bardhë |
| Regjistrimi i terreneve nga prerjet ilegale | - Me regjistrimin e terreneve kemi filluar por nuk kemi arrit të përfundojmë nga arsyeja se kushtet klimatike na kanë vështirësuar punën në terren. Mbetet të përfundohet regjistrimi, në moment kur kushtet klimatike të jenë të përshtatshme për të filluar punën pa pengesa (bora me trashësi të lartë, në viset malore pengon kryerjen e regjistrimit të dëmeve pyjore). |
| Pranimi dhe vendosja e kërkesave të pronarëve për pyjet private | - Janë pranuar **193** kërkesa për prerje në pyjet private të cilat janë aprovuar, Nga kërkesat e aprovuara janë vulosur **4822.43 m³**, masë drusore për djegie dhe **146.81m³** trupa teknik, të lejuar për prerje nga APK-ës, për vitin 2021. Të hyrat nga taksat për shërbime në pyjet private janë realizuar **6,452.28 €**, të cilat janë derdhur në llogarinë e buxhetit të konsoliduar të Kosovës. |

**Prioriteti 10: Zhvillimi i bujqësisë, krijimi i vendeve të reja të punës , rritjen e të ardhurave shtesë në zonat rurale dhe mbrojtja e pyjeve**

KAÇANIKU

| Aktivitete kryesore për realizimin e këtij prioriteti | Arritjet /progresi/performanca kyçe gjatë vitit 2018 |
|---|---|

KAÇANIKU

| | |
|---|---|
| Shqyrtimi i kërkesave,<br><br>Mbështetja e fermerëve me mjete nga buxheti komunës | Janë shqyrtuar të gjitha kërkesat e parashtruara nga qytetarët dhe për vendosjen e kërkesave te tyre qytetarët janë informuar me kohë, gjithashtu kjo drejtori është angazhuar në mbështetjen e fermerëve përmes realizimit të projekteve me mjete nga buxheti komunës, nga projektet e realizuara kanë përfituar **405** fermerë:<br><br>* Nga projekti mbështetja e fermerëve me serra në sipërfaqe prej 50m$^2$ kanë përfituar 70 fermerë, shuma e mjeteve **27,961.50€**, participim i fermerëve **7,000.00€**. Nga projekti për mbështetje të fermerëve me koshere bletësh kanë përfituar 94 bletarë (382 koshere bletësh) , vlera projektit **11,976.00 €**, participimi i fermerëve **2,395.20€**, nga projekti për mbështetje të fermerëve me makinë mjelëse për lopë qumështore kanë përfituar 56 fermerë, vlera projektit **11,200.00€**, participimi i fermerëve **2,240.00€**. Nga projekti për mekanizëm bujqësor (freza për tërheqje me traktor kanë përfituar 47 fermerë, makina spërkatëse për kulturat lavërtare 24 fermerë dhe makina shpërndarëse të plehut mineral 19 fermerë), vlera projektit **47,302.80€**, participimi i fermerëve **7,883.80 €**<br><br>Nga projekti për mbështejen e fermerëve për mbjellje veshtore – grurë, kanë përfituar 95 fermerë, të cilët janë mbështetur prej **75-150 €**, varësisht prej sipërfaqes së mbjellur, vlera e projektit **12,990.00€.**<br><br>Këtë vit kemi realizuar edhe projektin për rregullimin e kanalit të ujitjes në lagja Vishaj, fshati Dubravë në gjatësi prej 920m. vlera e projektit **16,958.00 €**<br><br>Sa i përket kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore, janë shqyrtuar 17 kërkesa, prej të cilave 8 janë të miratuara, 2 e refuzuara, 7 në proces për shqyrtimit.<br><br>Sipërfaqja e tokës bujqësore që është lejuar ndërrimi i destinimit është **6819 m².** Nga vendosja e kërkesave për ndërrim destinimi të tokës bujqësore në ndërtimore janë krijuar të hyra në shumë prej **5,583.00€ .**<br><br>Janë shqyrtuar 58 kërkesa të natyrës së ndryshme prej të cilave 19 vlerësime për dëmet e shkaktuara nga Bechtelenka dhe 7 kërkesa tjera për vlerësimin e dëmeve nga vërshimet e tokave bujqësore nga të reshurat e dendura dhe dëmet e shkaktuara nga egërsirat |

KAÇANIKU

| | |
|---|---|
| Mbështetja e fermerëve me këshilla profesionale | Fermerët kanë përfituar njohuri teorike dhe praktike për temat e shtjelluara nga trajnimet e organizuara gjatë vitit 2018, 16 trajnime gjithsejtë 369 fermerë. Trajnimet janë organizuar me këto tema të cekuar me numër pjesëmarrësve siç vijon:<br>1. Higjiena e qumështit- Mastiti (14)<br>2. Mbarsimi artificial te kafshët ( 14)<br>3. Përgatitja e kafshëve për kullosa (16)<br>4. Kultivimi dhe rëndësia ekonomike e lajthisë dhe arrës (15)<br>5. Kultivimi i gjedhit për mish(15)<br>6. Sistemi ujitjes te bimët mjekësore(15)<br>7. Roli dhe rëndësia e përdorimit të nënprodukteve në racionet ushqyese - (11)<br>8. Konservimi i pemëve dhe perimeve dhe përgatitja e reçeli, mermeladës (12)<br>9. SËMUNDJA GUNGORE TE GJEDHI - (15)<br>10. Rëndësia e paketimit dhe etiketimit të produkteve ushqimore (vendore (22)<br>11. Të ushqyerit e gjedhit në bazë të ciklit prodhues (13)<br>12. Analizat e dheut- (15)<br>13. Trajtimi I thundrave tek gjedhi -39<br>14. Analizat e dheut- (16)<br>15. Të rinjët në Agrobiznes -37<br>16. Përdorim i Makinave Bujqësore-freza, spërkatëse dhe shpërndarëse të plehut mineral -90 |

| | |
|---|---|
| Bashkëpunimi me MBPZHR dhe OJQ- ët | Gjatë kësaj periudhe raportuese Drejtoria e BZHRP-së ka bashkëpunuar me Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural dhe me shoqatat (OJQ-ët) vendore lidhur me organizimin e trajnimeve në fushën e bujqësisë.<br><br>Bashkëpunimi me MBPZHR-së ka qenë kryesisht në implementimin e projekteve të ministrisë siç janë: Projekti i shërbimeve këshillimore, projektet për subvencionim të fermerëve për lopë qumështore, kafshë të imëta (dele, dhi), bletë, projektet për subvencionimin e mbjelljeve pranverore, vjeshtore, subvencionimin e kulturave perimore, pemëtare dhe në projekte për aplikim në grande. Të gjithë fermerëve të cilët kanë qenë të interesuar për aplikim, i është ofruar ndihmë në kompletimin e dokumentacionit të kërkuar për aplikim në subvencionet dhe grandet që ka ofruar MBPZHR. Të gjitha aplikacionet e fermerëve për subvencione janë pranuar në zyrën e DBZHRP-së, të cilat të kompletuara janë dorëzuar në MBPZHR.<br><br>Nga projektet e MBPZHR për subvencionim, në komunën tonë kanë aplikuar 415 fermerë. Shuma e mjeteve të paguara nga subvencionet deri tani është 254,197.00 €, ndërsa në projektet e grandeve ka përfituar një fermerë në vlerë te përgjithshme prej 25,143.30 €, |
| | |

| | |
|---|---|
| Organizimi në mbrojtjen e pyjeve nga prerjet ilegale përmes shtimit të masave të veprimit në teren | - Rojet e pyllit dhe stafi i sektorit të pylltarisë, janë angazhuar për pengimin e dëmtimit të pyjeve nga prerësit dhe transportuesit ilegal të masës drusore.<br>- Janë konfiskuar **42.92m³** ose shprehur në (mh.) metër hapësinore **60.51(mh)**, prej kësaj masę drusore 40%, sipas marrëveshjes i takojnë Shoqatës së Invalidëve të Luftës (SHIL) ndërsa pjesa prej 60% e masës drusore të konfiskuar do të ndahen shkollave që kanë mungesë të masës drusore.<br>- Janë ngritur **233** fletëparaqitje, prej tyre për kundërvajtje **216 dhe 17** për vepër penale. |
| Organizmi i takimeve me Kryetarin e Komunës, Komandantin e Stacionit Policor, Kryetarin e Gjykatës, Prokurorinë si dhe takimeve të rregullta javore me stafin e sektorit të pylltarisë. | Për mbajtjen në kontroll të gjendjes së pyjeve, përmes koordinimit të aktiviteteve të përbashkëta: Komunë, Polici, Gjykatë dhe roje të pyllit, kemi organizuar takime të përbashkëta, me qëllim të ndikimit në pengimin e prerjeve ilegale të pyjeve. |
| Monitorimi dhe përcjellja e aktiviteteve të operatorëve ekonomik në shfrytëzimin e ngastrave pyjore të dhëna me tender.<br><br>Rrallimi në rajonin e Biçecit | - Realizimi planit të paraparë për vitin 2018, shfrytëzimi i ngastrave të caktuara për prerje sipas planit menaxhimit, zgjedhja e operatorit ekonomik i cili i ka plotësuar kushtet sipas procedurave të prokurimit. Nga shitja e masës drusore me tender janë realizuar mjete në shumë prej **29,697.70 €**<br>- Janë kryer rrallime në njësinë menaxhuese " Uji i Bardhë", në sipërfaqe prej 10 ha, në vendin e quajtur "Lugu i Rubit" |
| Regjistrimi i terreneve nga prerjet ilegale | - Regjistrimi i dëmeve në terren sipas rajoneve, duke përjashtuar pjesën e Parkut Kombëtar "Sharri", që është kompetencë e MMPH |

| | |
|---|---|
| Pranimi dhe vendosja e kërkesave të pronarëve për pyjet private | - Janë pranuar **151** kërkesa për prerje në pyjet private ndërsa 151 prej tyre janë aprovuar, Nga kërkesat e aprovuara janë vulosur **4972.50 $m^3$** masë drusore për djegie për vitin 2018 të lejuar për prerje nga APK-ës. Të hyrat nga taksat për shërbime në pyjet private janë realizuar **10462.76€**, të cilat janë derdhur në llogarinë e buxhetit të konsoliduar të Kosovës. |

## Zyra e prokurimit

Objektivat e Zyres së Prokurimit si njëisi në kuader të zyres së kryetarit kanë qenë në përmbushjen e kërkesave të njisisve kërkuese respektivishtë realizimin e planit të prokurimit në përmbushjen e kërkesave të njisive kërkuese dhe realizimin tyre.

Të gjitha aktivitetet e prokurimit janë realizuar bazuar në në harmoni të plotë me komtetencat e Zyres se Prokurimit respektivishtë Ligji për Prokurimin Publik të Republikes së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotsuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 dhe RRUOPP në fuqi.

Në Raportin Vjetor të punës për periudhën 1 janar 2021 deri më 31 dhjetor 2021, janë aktiviteti i zyres së prokurimit lidhur me Raportimet, Procedimi i kërkesave të Drejtorive për Tenderimin dhe implementimin e Kontratave për Furnizime, Shërbime dhe Punë të realizuara gjatë vitit fiskal 2021.

Janë pregatit Raportet vjetore dhe janë përcjellë Raportimi pë Kontratat e nenshkruara bazuar në formularin standar të KRPP-së B53 .

Gjatë vitit fiskal 2021 janë zhvilluar proceduarat e prokurimit përmes sistemit e-prokurimi dhe janë publikuar respektivishtë janë Kontraktuar 105 Kontrata për Shërbime; Furnizime dhe Punë në shumë prej 3.297.506,68€ ndersa vlera e planifikuar për keto Projekte ka qenë 3.943.080,70€.

Në bashkëpunim me njisitë kërkuese respektivishtë drejtoritë janë publikuar procedurat e prokurimit bazuar në kërkesat dhe nevojave të njisive kërkuese gjithsejtë 124 procedura prej të cilave janë Kontraktuar 105 projekte dhe 19 procedura janë anuluar per shkak se nuk ka pasë oferta apo ofertues të pa përgjegjeshem dhe janë Ritenderuar dhe ate:

-Janë procesu Procedura të prokurimit me vlera minimale respektivishtë më pakë se < 1000,00 € janë 26 aktivitete te prokurimit;

- Janë procesu Procedura të prokurimit me vlere te vogël respektivishtë më pakë se ≥1000.00 €.< 10.000,00€. janë 39 aktivitete te prokurimit;

- Janë procesu Procedura të prokurimit me vlerë të mesme respektivishtë më pakë se ≥10.000.00 € janë 59 aktivitete te prokurimit;

Projektet e Kontraktuara janë me sa vijonë:

-Kontrata për punë 44 procedura;

-Kontrata për Hartimin e Projektve 5 procedura;

- Kontrata për Sherbime kontraktuale-Kontraktues individual 5 procedura;

- Kontrata për Furnizime 39 procedura;

- Kontrata për Shërbime 10 procedura;

Bazuar në përgjegjësit dhe obligimet e Zyres së Prokurimit si dhe Ligji për Prokurimin Publik të Republikes së Kosovës nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotsuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 respektivishtë Neni 10 Mjetet për promovimin e Transparencës janë dhënë qasje në kërkesat e Operatorëve ekonomik për qasje në dokumente publike ku kanë pasë qasje dhe nga OJQ dhe institucione tjera.

Gjatë vitit 2021 stafi i Zyres së Prokurimit ka marrë pjesë në takime të Organizuara nga KRPP, Kolegjiumi i Prokurimit.

Kryetari i Komunës së Kaçanikut

Besim Ilazi